

VI

SEANCA E MBAJTUR

Më 24 maj 2002

II

Z. NAIM MALOKU,

Planifikimit hasinor, qëndrimi i Komisionit është se Qeveria e Kosovës në programin e vetë nuk i ka dhanë rëndësi të duhur kësaj çështje, duke marrë parasysh të kaluarën e Kosovës, luftën dhe zhvillimet në këtë drejtim të pasluftës, pra në Kosovë. Të mos e zgjas me vërejtjet në lidhje me këtë çështje. Komisioni parlamentar pra sygjeron Qeverinë që Projektpropozimin për programin e Qeverisë që ia ka dorëzuar Ministria e Qeverisë të merret në tërësi si program i Qeverisë së Kosovës, pra në pikën e 9 të inkorporohet në tërësi projektpropozimi për programin e Qeverisë që i është dorëzuar nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor. Më lejoni që ti jap edhe vërejtjet e mia si deputet në programin e Qeverisë dhe kjo është si vijon. Energjetikës nuk iu ka dhënë rëndësi e veçantë në aspektin e drejtimeve pra mungon në programet e Qeverisë drejtimi i zhvillimit të energjetikës. Energjetika është lëmi e cila kërkon programe afatmesme, afatgjata, pra këtu mungojnë drejtimet e zhvillimit të kësaj lëmie në Kosovë. Është shumë me rëndësi që kjo Qeveri tani tu parasheh drejtimin e zhvillimit të kësaj ekonomie, të kësaj dege. Tjetër mungojnë prioritetet në të gjitha drejtimet, duke filluar nga bujqësia, mendoj se duhet më tepër ky Program ti paraqes edhe prioritetet në bujqësi, për shkak se bujqësia është ajo degë e ekonomisë e cila praktikisht do të ketë punësim më të madh të qytetarëve të Kosovës. Më lejoni t'i jap vetëm një shembull. Në Kosovë importohen çdo muaj 400 ton cigare, në qoftë se Ministria e Bujqësisë i kushton rëndësi, industrisë së duhanit, atëherë njohuritë i kemi se industria e duhanit i ka pasur 10 mijë kooperues individual në Kosovë që do të thotë praktikisht 50 mijë të punësuar dhe janë investime të cilat kthehen shumë shpejt dhe me të cilat punësohet numër shumë i madh i punëtorëve. Pra, unë dhash vetëm një shembull, e kemi shumë shembuj tjerë. Pra bujqësisë duhet kushtuar një rëndësi shumë më e madhe. Keni kujdes në kohë ju lutem, une jam edhe si kryetar i komisionit parlamentar.

Në prioritetin 4, transporti, posta dhe sistemet informative, transportit ajror civil nuk është cekur këtu se çfarë drejtimi do të merret Qeveria e Kosovës, çfarë qëndrimi ndaj kësaj lëmie, pra transporti ajror civil. Unë jam i vetëdijshëm se kjo është në kompetenca të UNMIK-ut, mirëpo kjo Qeveri duhet të ketë edhe strategjinë e ndarjes së kompetencave në këtë lëmë këtu nuk ka. Mediat, në Kosovës nuk janë drejtimi i zhvillimit të medijave publike në Kosovë nuk janë paraparë në këtë program. Jam i detyruar ta ndërpres, Ju falënderit edhe njëherë.

Z. SABIT RRUSTEMI, le të përgatitet Sabit Idrizi,

E nderuarra Kryesi, i nderuari ministër dhe të nderuar deputetë, pasi kjo përshëndetje nuk do të ndikojë në kufizimin e kohës për diskutim, në tërësi në vijë të përgjithshme mbështes programin e ofruar me gjithë vërejtjet që i kam, do ta kisha mbështetur edhe më fuqishëm sikur ky program të ishte në rend të parë më pak gabime gjuhësore, është fare i pak lektoruar nën 1 dhe e dyta më pengon shumë në programin e Qeverisë përsëritja e fjalës apo foljes **duhet** me dhjetëra herë dhe do ta lusja Qeverinë që këtë ta zëvendësojë me **do të**, p.sh duhet ta bëjmë, por do të bëjmë, sepse foljen duhet na përket neve më tepër si deputet. tjetra po ndalem te kultura, kujtoj që në programin e kulturës duhet të përfshihen konsolidimi dhe avansimi i mëtejshëm i institucioneve të kulturës ato dihet të cilat janë dhe, veprimi horizontal dhe ndërlidhja më e mirë me qendrat kulturore nëpër komuna, gjë që ka munguar deri më tash. Pastaj një kujdes i veçantë për bibliotekat, zhvillimi dhe modernizimi i teatrove profesionale në Kosovë; poashtu një kujdes që duhet të tregohet në programin e kësaj njësie duhet të jetë edhe përkrahja e shoqatave profesionale kulturore, me prioritet të veçantë Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës, kompozitorëve, artistëve figurativ etj. Është edhe një çështje tjetër që unë nuk e pash në programin e kësaj Qeverije krijimin e orkestrit simfonik të Kosovës, pastaj nxitja dhe mbështetja për iniciativat e pavarura në kulturë. Gjithashtu konsideroj që kërkimet arkeologjike duhet ta kenë një prioritet të veçantë në këtë njësi bashkë me çështjet tjera të trashëgimisë kulturore që këtu na jepet me një term pak sa të çuditshëm. Trashëgimia kulturore multietnike, nuk di ndoshta do të ishte mirë të sqarohet kjo çështje te sfera e rinisë, kujtoj që më shumë duhet t'i jpet prioritet trajnimit dhe edukimit dhe integritetit të

rinisë kosovare se sa të fushatës kundër duhanit, pastaj sigurimit të kushteve për shkollim dhe bursa si dhe specializimin e të rinjëve jashtë, karshi asaj që e ceka më lartë. Te çështja e sportit veç u përmend në fillim nga ministri, unë posaçërisht nuk jam i brengosur, pse në Programin e Qeverisë mungon termi i ashtuquajtur Jugosllavi, më brengos një çështje tjetër, mungesa e relacioneve me presidencën e Kosovës dhe me shoqërinë civile të saj, sepse këtu përmendet bashkëpunimi ndërkombëtar, bashkëpunimi me udhëheqjen ndërkombëtare, a ne e dijmë se edhe këto dy komponente janë e Kosovës, prandaj le t'i ketë në konsideratë Qeveria bashkë me një forcë të madhe të Kosovës, gruan që poashtu fare nuk e ka në Program, mbase edhe nga fakti se kjo është Qeveri burrash dhe i falet, Ju falënderit.

Z. SABIT IDRIZI, nga koalicioni "Vatan" lë të përgatitet Haki Shatri.

Z. SABIT IDRIZI,

Poštovano predsedništvo, poštovani predsedniče drage uvažene kolege, mi smo u prezentaciju, rekli da ćemo podržati Program Vlade sa određenim primedbama koje ćemo izneti i kao poslanici i kao šef poslaničke grupe, mislim da je Program sve obuhvatan, mada ja nisam imao puno vremena da ga razradim. Od juče sam i član ove Skupštine i mislim da sam najmlađi tu po stažu. Problemi za koje se zainteresuje moja zajednica odnose se na povratak raselenih, povratak oduzete imovine, problemi u obrazovanju, infrastrukturi i u ostalim segmentima. Mislim da problem obrazovanja manjinskih zajednica, posebno bošnjačke i turske, mislim da je značajan, jer nakon rata na Kosovu, naša zajednica ostala bez više i visokog obrazovanja. U ovom trenutku mi smo imali kontakte sa Dagsnerom i ostali smo na nekoj tački koja nije baš zadovoljavajuća. Nadamo se da ćemo sa novom Vladom u Prizrenu, Peći i ovde u Prištini dobiti svoje mesto, mislim na Višu Pedagošku u Prizrenu, Fakultet za Biznis u Peći, i na fakultetu ovde u Prištini, mislim na katedru za bosanski jezik i književnost, to su naši planovi i mislim da će to biti jedan od zadataka Vlade. Međutim mislim da problemi obrazovanja nisu samo za manjinske zajednice, oni su kompletni i sa ovakvim položajem prosvetnih radnika ja se plašim da Kosovsko obrazovanje ući u reforme. Ni

imamo tamo pripremljen projekat ali on nemože biti realizovan, niti zakon može sproveden ako imamo ovaj status koji imaju prosvetni radnici, Vi znate da u nekoliko zadnjih dana bilo i štrajkova , odnosno obustava rada , ja neznam kako će biti završena ova godina , jedan ministar u obrazovanju mislim da imaju priličan zadatak u daljem radu.

To je problem koji je veoma bitan za sve opet građane Kosova, problem dokumenata, one dokumente UNMIK-'a koje imamo vi znate koliko su važeća , a mislim da UNMIK mora da bude agresivni u nas, da to dokumenta proširi da ta dokumenta budu važeća, inače ljudi imaju problema, da iz Makedonije verovatni ste čuli da ima ponuda, a da sutra još jer ljudi imaju problema pa onda prihvataju da dobiju neki pasoš u nedostatku je jedan dobar deo naših ljudi boravaju vani. Ja shvatam da određeni dokumenti možda čekaju status konačni , međutim postoji dokumenti koji nisu vezani za to. Mi još nemamo pečate po školama, opštinama. Naši ljudi moraju da čekaju satima, danima da dobiju najobičniji dokumenat, za rođenih, i za nekih običnih, vozačke dozvole ja neznam dali su to vezani za neki status i td. To su dokumenta koja UNMIK ima pretrumbu tu administraciju glomazna ali troma i nekako mislim da nekako malo nam daju krila da neke stvari sami rešavamo. Prvo je pitanje dali mi neke stvari imati u kompetenciji ali smo u nekim stvarima isputavani da možemo da radimo najbolje . Održavaju se mnogi treninzi koji koštaju prilično , neznam mi nismo počeli od nule i mi znamo šta je znači ima treninga koji su na nivo osnovi , znači škole i tkd. Ima kvalitetnih treninga , ima koji pomažu ali i mi imamo neko iskustvo, i mi znamo od prilike da radimo, nismo mi od juče, mi imamo škole, mi imamo univerzitete, mi imamo školovane ljude i mi znamo kako treba, mnogo treninzi se koriste da se prebiju možda i neke pare i td. Ako grešim neka bude ali mislim da ima sa takvom namerom previše se organizuju ali neznam koliko su efekti , bilo da su u obrazovanju, bilo da su u drugim oblastima, dok se neki projekat progura možda više polovinu novaca ode na pripremu treninge i td i neznam šta ostaje za realizaciju Programa. Imamo problem sa posebno planinski delovi oko pristupa telefoniji no čitave oblasti koje u opšte nisu pokrivena nikakvim signalom ne ne znam kako će to biti odavde iz Skupštine zajista moram da idem na brdo deset kilometara da bi možda nekoga dobijo nije pokriven takođe ni naš televizijski, pa su ljudi upućeni da prate signale drugih stanica satelitskih da kupuje itd, nekada je bilko

obernuto danas to opet drugi rade, mislim da moramo pokriti našu teritoriju ekim valanim signalama , da bi mogli imati ljude inače zajednce manjine osnovi zadatak njihov je integracija u kosovsko društvo bez toga ja mislim da ćemo imati probleme svi integracija ne znači asimilaciju , integracija ne znači nestajanje zajednica, integracija znači samo korak napred, u budućnost Kosova Hfala.

Fjala i jipet deputetit Haki Shatri e le të përgatitet Fatmir Lima. Heq dorë nga diskutimi. Le të përgatitet Ramadan Kelmendi.

Z. HAKI SHATRI,

Kryesi e nderuar, të nderuar kolegë deputetë, kryetar dhe Qeveri e respektuar. Komisioni për buxhet e ka shqyrtuar programin e Qeverisë dhe këtë program e ka vlersuar dhe e ka qmuar si një program i cili i përmbush dhe, i përmban qëllimet, masat dhe aktivitetet për relalizimin e tij. Si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga mënyra e çasjes, materiali është vlerësuar si serioz dhe prandaj nga ky Komision është vlerësuar se meriton të përkrahet dhe të miratohet nga ky Kuvend. Në shqyrtim të këtij materiali Komisioni normalisht ka pasur edhe vërejtje, të cilat në qoftë se eliminohen do të rritet cilësia dhe kualiteti i këtij programi. Nuk do të flas në emër të Komisionit por do ti përcjell disa vërejtje që i kam evidentu si individ e jo si Komision , së pari siç është ndëgjuar edhe prej një deputeti tjetër, është mirë që ky material të lektorohet dhe stili të unifikohet në mes të pjesëve të ndryshme dhe lëamenjve të ndryshëm sepse kam përshtypjen që është punuar nga autorë të ndryshëm dhe ka nevojë të unifikohet stili, dhe sintaksa në shumë vende nuk është në gjuhën shqipe dhe në shumë vende mbetet pa kuptim dhe disa vërejtje mund të bëhen për arsye se nuk kanë kuptim në gjuhën shqipe .

Nën 2, mendoj që do të ishte mirë që në fillim në hyrje të sqarohen disa rrethana në të cilat Qeveria dhe institucionet tona e realizojnë këtë program. E kam fjalën për përkrahimin e kompetencave që ka Qeverija, ato që i ka të përbashkëta me subjektet i ndërkombëtare këtu, dhe ato fusha që kjo Qeveri nuk ka kompetenca dhe prandaj nuk ka përfshirë këtu dhe kjo për arsye se do të jetë më e mirë dhe më e qartë për qytetarët tanë sot , por edhe për ata që nesër do ta analizojnë këtë Program dhe rezultatet që ka mbrri kjo Qeveri në mandatin e vet.

Vërejtje tjetër e imja është, tash është konkrete në faqën 2 ku flitet për stabilitetin. Pasusi i dytë fjalia e fundit është kur flitet për destabilizuesit e vijës së demarkacionit, ndoshta është fjala mu te sintaksa. Nuk është bash e qartë, në ken mendohet destabilizues i vijës së demarkacionit, në faqën e 4 në pasuesin e 3 ku flitet për problemet e personave të zhdukur, po citoj është një fjali nëpërmjet themelimit, të Komisionit të përbashkët qeveritar për persona të zhdukur, nuk thuhet me kënd do të përbëhet Komisioni i përbashkët ose unë ose skam kuptuar, poashtu në faqën 5 të pakti i stabilitetit duhet të shtohet se Kosova që të mund të përfitoj nga fondet që ofrohen nga fondacionet ndërkombëtare duhet të përgatis projekte nga infrastruktura e cila e mundëson intgrimin në rajon, nuk mjaftojnë kontaktet, zyrat por edhe duhet programe konkrete të infrastrukturës. Faqe 7 pika 1 ku flitet për ekonominë unë e kam përgaditur një pasus, dhe mendoj që pasuesi i parë duhet të zëvendësohet, unë kam përgaditur dhe do t'ia lë Kryesisë në disponim nëse e shihni të arsyeshme mundeni ta lexoni ose i ja jap Kryesisë edhe kështu, sepse koha nuk po mjafton. Në faqen 11 ku flitet për privatizimin është mendim edhe i Komisionit, por edhe mendim i imi Agjensioni për Privatizim drafti i themelimit të Agjencionit, mos të aprovohet nga Qeveria dhe mos ti ipet viza për miratim para se të diskutohet në këtë Kuvend sepse ka vërejtje serioze, materiale dhe të tjera. Nuk është folur te pjesa për telekomunikacionin, diçka për frekuencat, është pak problematike se kush do ti kontrollojë dhe kisha pasur dëshirë për të ditur si qëndron puna aty. Te pjesa për çështje jorezidente, edhe deputeti nga Aleanca e ka përmendur por edhe unë dëshiroj ta përmend këtu. Nuk është folë se çka do të merret për qytetarët tanë që nuk e kanë të zgjidhur në asnjë formë disa probleme elementare, çështjen e dokumentacionit, as të identifikimit as të udhëtimit as nuk mund të votojnë e as nuk janë qytetar të Kosovës tash as të shteteve ku kanë marrë strehim të përkohshëm. Ndoshta do të ishte mirë që të merren masa në atë drejtim dhe për krijimin e kushteve për jetë në viset pranëkufitare ato zona sot po shprazen për shkak të mungesave elementare për jetë, ujë rrymë etj, Më falni.

Fjala i jpet Ramadan Kelmendit, kurse lë të përgatitet deputetja Besa Gaxherri,

Z. RAMADAN KELMENDI,

I nderuari kryesues, e nderuar Kryesi e Kuvendit, të çmuar deputetë, ministër dhe kryeministër. Shfrytëzoj të drejtën e përcaktuar me Rregulloren e punës së Kuvendit të Kosovës, ta paraqes një reagim dhe për këtë kërkoj që të mos llogaritet në diskutimin .Ky program nuk është i Kosovës dhe Metohisë, por është program i Qeverisë së Kosovës, e dyta, kërkoj nga kryesia e Kuvendit, nga organet e këtij Kuvendi që në të ardhmen mos t'i lejohet nënçmimi dhe provokimi i deputetëve në punën e këtij Kuvendi ngase një metod e tillë krijon probleme, që në të vërtet nuk i dëshirojmë. Kur ne sot kemi shtruar në shqyrtim programin kuvendor të Qeverisë së Kosovës, vlerësoj se kemi për obligim si deputet që atë ta shqyrtojmë nga të gjitha aspektet , ti japim vërejtjet, plotësimet dhe sygjerimet tona me të vetmin qëllim që ta begatojmë dhe ta funksionalizojmë. Jam i vetëdijshëm që ky program gjendet në mes të kufizimeve dhe kompetencave të Qeverisë , gatishmërisë dhe dëshirës së Qeverisë për një program sa më të mirë dhe gjendjes së rëndë ekonomike në Kosovë. Unë duke analizuar këtë Program paraqes vërejtjet e përgjithshme dhe ato konkrete, vlerësimi individual është se vërejtje të përgjithshme janë: se programi është shumë i përgjithësuar, pa zërthime konkrete, nuk ka afate për realizimin e të njejtit, nuk janë përcaktuar bartësit e realizimeve të tij, nuk është sanksionuar përgjegjësia për mosrealizimin e tij metodologjia e shtruarjes së programit nuk është adekuate dhe jo aq bashkohore dhe empirike , prioriteti i miratimeve të ligjeve nuk është në harmoni me kërkesat e miratimit të tyre. Ndërsa si çështje të veçanta vlerësoj: në faqën 7 të programit ku flitet për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe ku bëhet fjalë lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik , mendoj se detyrë prioritare e Qeverisë është ndërtimi i sistemit ekonomik, si dhe të përcaktimit të politikës ekonomike në Kosovë,këto dy komponente programin e Qeverisë nuk e përshkojnë. Kjo do të thotë se pa sistem ekonomik dhe pa politikë ekonomike nuk mund të kemi zhvillim të qëndrueshëm ekonomik . Tre poashtu Qeveria është dashur ta hartojë strategjinë e zhvillimit ekonomik dhe atë ta përfshijë në këtë program qeveritar. Katër, theksoj se këtë së paku strategjia e zhvillimit nuk

mund të caktohet pa përcaktimin e strategjisë së zhvillimit ekonomik, nuk mund të caktohen edhe prioritetet e zhvillimit. Ky program qeveritar nuk parasheh bazën e zhvillimit harmonik të regjioneve. Mendoj se vetëm me zhvillimin e sektorit privat dhe ndërtimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, nuk mund të arrihet qëllimi dhe ndryshimi thelbësor i strukturës ekonomike në Kosovë. Fare nuk i është kushtuar vëmendje industrializimit si domosdoshmëri e zhvillimit ekonomik. Në faqën 3 bashkëpunimi ndërkombëtar, mendoj se me këtë program Qeveria është dashur të parasheh dhe të përcaktoj si çështje të mundshme edhe bashkëpunimin me institucionet financiare ndërkombëtare, Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore etj.

Në faqën 13, financimi ndërqeveritar, mendoj se Qeveria në program duhet t'i përcaktojë kriteret me të cilat do të bazohet financimi i buxhetit të komunave nga mjetet plotësuese të buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Në faqën 14, sistemi bankar, mendoj se kamatat e bankave për sistemin kreditor janë të larta dhe nuk janë në funksion të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Në këtë rast programi i Qeverisë duhet të ketë përparësi dhe mundësi të intervenimit. Dy fjalë për bujqësinë dhe zhvillimin rural, në faqën 17 në këtë Program nuk bëhet fjalë për mbrojtjen e tokës bujqësore, regjenerimin e pyjeve, stimulimin e bujqësisë, shfrytëzimin racional të shtetit Ibër-Lepenc, dhe të liqenit të Gazivodës. Arritja e standardeve evropiane në arsim me hapësirën për mëtej për nxënësit tonë më të kufizuarit në botë, pagat e punëtorit të arsimit, dhe reforma eksperimentale nuk janë elemente që shpiejnë në avansimin e arsimit. Në faqën 26 gjenerimi i punësimit, ky program i Qeverisë shumë pak merret me problemin e punësisë, i cili tash është ndër më të lartit në Evropë, mos të themi edhe më gjërë nuk e paraqet as numrin e as strukturën e papunësisë si dhe as angazhimin e Qeverisë për zbutjen e papunësisë, dhe në veçanti nuk përfshihet riaktivizimi i komplekseve industriale ekonomike si p.sh. kompleksi "Trepça", për absorbimin e punëtorëve të dëbuar me dhunë nga vendet e tyre të punës nga regjimi serb, pozita e të cilëve është e rënd dhe e paprekshme. Qeveria lidhur me kthimin e popullatës shqiptare në pjesën veriore të Kosovës nuk parasheh asgjë. Ju informoj se 26840 qytetarë shqiptarë të Mitorivës veriore me rrethinën nuk janë kthyer akoma në shtëpitë, pronat dhe banesat e tyre, dhe 82% të hapsirës së Shalës është e pa banuar me popullatë aktive, autoktone,

Une kam edhe disa gjëra dhe shpresoj se Qeverija do ti merrë në konsiderat këto, Ju falënderit.

Z. HYDAJET HYDAJETI, është vërejte edhe nga Kryesia që të kemi kujdes edhe përsëritjet t'i evitojmë sa të ketë mundësi kurse çështjet që mund të bashkangjiten edhe me shkrim, lë t'i praktikojmë edhe këto në funksion të kursimit të kohës .

Fjalën e ka Besa Gagjerri, le të përgatitet Fatmir Rexhepi.

Z. BESA GAGJERRI,

E nderuara Kryesi, i nderuari kryeministër dhe ministra, të nderuar deputetë. Siç e tha edhe kryetari i Komisionit për buxhetin , komisioni i buxhetit programin e Qeverisë e kemi pasur në rend dite më datën 20.5. 2002, të cilin program e kemi vlersuar pozitivisht, kuptohet me disa vërejtje. Unë mendoj se këtë program është dashur apo duhet që secili komision ta shqyrtojë lëminë përkatëse , të jap vërejtjet sygjerimet apo plotësimet e veta, në mënyrë që të shkojë puna më mbarë dhe ma shpejt. Por unë mendoj dhe shtrohet pyetja sa dhe si mund të realizohet ky program , unë isha ndalur te zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik i cili mendoj se është përfshirë mjaft mirë anise është në vija të trasha, por është një program i cili i përgjigjet edhe programit të LDK-së për ekonomi, dhe isha ndalur te privatizimi , ku në programin e Qeverisë në faqën 11 thuhet Qeveria e Kosovës do të merrë pjesë aktivisht në përpjekjet për privatizim për të siguruar përfitime më të mëdha të mundshme për ekonomi dhe popullin e Kosovës përmes anëtarësisë së saj në këshillin ekonomik dhe fiskal, dhe me bordin e drejtorit të Agjensisë i cili do të ngarkohet që të merret me përpjekjet për privatizim, thotë që Qeveria do të promovojë një strategji dhe një program transparent dhe gjithpërfshirës të privatizimit, duke pasur parasysh rregulloren e propozuar nga ky agjension. Po sikur të ishte kështu është shumë mirë e theksuar por të nderuar deputet dhe e nderuara Kryesi e Kuvendit kisha kërkuar që sa më shpejtë të jetë në rend dite draftërregullorja e UNMIK-ut për privatizim, sepse ne komisioni i buxhetit e kemi debatuar apo kemi dhënë sygjerimet tona në këtë drejtim sa i përket kësaj Rregulloreje, këtu shihet shumë kuart se

kjo Rregullore jep shumë pak hapësirë ose fare pak, qoftë Qeverisë apo qfardo institucioni të Kosovës , për këtë problem shumë të ndishëm pasi që është privatizimi në qoftë se kam kohë, kisha dhanë vetëm edhe disa vërejtje sa i përket radhitjes së prioriteteve që i keni radhitur këtu në këto skemat , unë kisha mendu p.shprioritetet janë radhitur, i lartë, shumë i lartë , mesatarisht i lartë, kur është fjala për kodin doganor kisha mendu që ky mos të jetë mesatarisht i lartë por të jetë shumë i lartë, për arsye se ne e dim se doganat tona janë shumë diskriminuese, mos të hyj për të marrë kohë, dhe cilat norma ndikojnë në ekonominë e Kosovës dhe drejt në buxhetin e Kosovës, dhe prandaj unë kisha mendu që ky prioritet të jetë shumë më i lartë, pastaj është prioriteti i ligjit të shëndetit të bimëve, që e cakton standardin e shëndetit të frutave, perimeve, dhe drithrave të tjera bujqësore, e kjo që lidhet krejt me shëndetin e njeriut, ju lutem kisha mendu që edhe ky duhet të ketë një prioritet, se ne e dim se me qfarë ushqimi kemi të bëjmë në Kosovë, gjithashtu kisha mendu për ligjin mbi importin, eksportin të pesticideve të plehrave, ani pse kjo për këtë moment është e vonuar por kisha mendu që sidomos në të ardhmen sepse tash mbjelljet veq janë kry, por në të ardhmen të jetë prioritet shumë më i lartë, prandaj kisha mendu që ligji për menagjimin dhe përpunimin e ujit të jetë më i lartë, edhe në këtë drejtim që të rregullohet përdorimi i burimeve të ujit për bujqësi dhe industri dhe qëllime të tjera, gjithashtu të krijoj një drejtorat për menagjimin e përgjithshëm të përdorimit të ujit dhe të organizojë kompani komunale të ujësjellësit , ju lutem me prioritet mesatar , ne e dim se edhe me ujin kemi problem, kemi vise që nuk e dim se çfarë uji pihet dhe unë mendoj se edhe ky prioritet duhet të jetë shumë i lartë, prandaj kam mendu edhe ligji mbi tokën bujqësore, duhet të jetë me prioritet shumë të lartë, pastaj është ligji mbi rregullimin e letrave me vlerë, jo këtë se kisha thanë, më falni , por kisha thanë edhe ligji mbi pyjet, që të jetë me prioritet shumë të lartë, pasi që ne e dim se pyjet tona janë gadi tërsisht të shkatërruara, mendoj se kam qen e shkurtër, ju falënderit.

Z. HYDAJET HYSENI, kemi kohë edhe për dy diskutime në rend janë deputeti Fatmir Rexhepi dhe Sabri Hamiti, nëse pajtoheni siç u tha më parë që në ora 13 ta ndërprejmë diskutimin është e juaja që të vendosni të ndërprejmë diskutimin deri në orën 14, 30

apo të vazhdojmë, por kështu ne kemi propozuar , pra të vazhdojmë edhe me këto dy diskutime dhe prandaj të shkojmë.

Z. FATMIR REXHEPI,

E nderuara Kryesi, i nderuari kryeministër, të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë. Programi i Qeverisë, pas debatit, mendoj që do të ketë përkrahjen e plotë të Kuvendit, të qytetarëve të Kosovës për relaizimin e plotë të këtij Programi që do të jetë me inters për zhvillimin e plotë të Kosovës, orientimet programore që janë vu në programin e përbashkët të Qeverisë , do të kisha fokusin atë që Programi ka mund të jetë më konkret prej objektivës strategjisë së realizimit e deri te implementimi. Nga ajo formë çfarë është dhënë, disa nga çështjet e veçanta e që ndonjëra edhe do të përsëritet, janë këto që po i veqojë, që kanë pasur vend për tu konkretizuar më shumë në kuadër të programit që ofron Qeveria, në rrugëtimin tonë drejt ekonomisë së tregut, të privatizimi. Mendoj se Qeveria është dashur të ofroj modelin e privatizimit me specifikat që i ka Kosova mbi bazën e përvojës dhe praktikës që ajo do të realizojë gjatë kësaj faze, posaçërisht është dashur, sipas mendimit tim që të rikonfirmohet qëndrimi i veçantë se për 400 ndërmarrje publike dhe shoqërore të Kosovës, baza për fillimin e privatizimit ose të kërkohet statusi legal i saj para 22 marsi. Është dashur e veçantë të jetë kjo, statusi juridik, ekonomik dhe politik çfarë e kanë pasur ndërmarrja e cila pastaj përjashton të gjitha ligjet e tjera të cilat edhe më herët që janë të pa pranueshme për ne.

U tha këtu për draftregullorën. Edhe unë them që ajo është e papranueshme nëse nuk ndryshohet pas debatit që do të bëhet për privatizimin. Për politikën doganore e mbështesim vetëm alternativën e dytë, e cila është dhënë nga Qeveria, dhe nuk duhet të figurojnë alternativa tjera. Dogana duhet të ekzistoj në shkallë të caktuar bashkë me TVSH-në dhe që të dyja pra të jenë të ndërtuara në programin e Qeverisë pa alternativa të tjera. Në program që ka pasur vend këtu së paku po e përsëris një çështje e veçantë që është për ekonominë dhe për popullin e Kosovës, çështja e resurseve energjetike dhe është dasht që në kuadër të programit të thuhet më tepër dhe më konkret rreth stabilizimit, rreth projektit aktual dhe rreth strategjisë të zhvillimit të energjetikës në Kosovë. Ngjashëm poashtu është dashtur të veçohet se është me rëndësi strategjike

poashtu uji dhe liqenet artificiale në Kosovë, që nuk figuron si projekt i veçantë që mendoj se duhet të jetë aty . Për mendimin tim një objektiv i posaqëm që është dashtë të shprehet brenda programit të Qeverisë , çka ka paraprë Qeveria dhe se a parashihet Qeveria lehtësimin dhe vlerësimin e dëmeve 10 vjeqare në ekonomi dhe përgjithësisht në Kosovë , pra ate që e ka bërë Serbia para dhe gjatë luftës. Të gjitha ato dëme materiale është dashur prerazi të fokusohen në programin e Qeverisë, si njëra ndër detyrat me të cilat duhet të ballafaqohemi, dhe e cila duhet ti adresohet dhe ti fakturohet Serbisë. Ju falënderit.

Fjalën e ka dikutuesi i fundit për këtë pjesë të Seancës,

Z. SABRI HAMITI,

Atëherë, fjalën e ka Nekibe Kelmendi,

E nderuara kryesi, i nderuari kryeministër dhe ju ministra, të dashur kolegë deputetë, shumë shkurt do të diskutoj . Qeveria e Kosovës ka menduar kësaj radhe për të tjerët dhe për të tjerët nuk ka mendu fare, nuk e ka paraparë në programin e vet që të inicojë nxjerrjen e ligjit për Qeverinë Nëse këtë e bën,atëherë i sygjeroj,që në ligjin për Qeverinë të ekzistojë edhe Ministria e Drejtësisë, meqë sipas Kornizës Kushtetuese, administrimi i gjyqësorit nuk është e drejtë e rezervuar për PSSP-në, por është e rezervuar për organet vetëqeverisëse të përkohshme të Kosovës.Ju falënderit .

Z. HYDAJETI që informimi të jetë i plotë edhe njëherë nëse jeni në dakord bëjmë një pauzë deri në orën 14, 30 që të sqarohemi përsëri mirë në drekë janë ftuar këtu në ndërtesën e Kuvendit, deputetet femra , të tjerët le të gjinden d.t.th. në ora 14,30 fillon diskutimi përsëri.

Z. HAJREDIN KUQI,

Vërejtjet dhe sygjerimet e mijja do t'i bëjë në emër të Komisionit për shkencë dhe teknologji, por natyrisht edhe si deputet i Kuvendit , kryesisht do të përqëndrohem në

fushën e arsimit. Mendoj se mund të orientohemi në tri vërejtje kryesore . Vërejtja e parë mund të jetë sa i përket formulimit të disa emërtimeve, p.sh arritja e standardeve evropiane. Konsideroj se do të ishte më mirë të quhej ngritja e cilësisë në arsim, pastaj nuk duhet të thuhet se më në fund me aprovimin e ligjeve do të hyjë në binarë sistemi i arsimit, ngase besoj se është një fjali mohuese për gjendjen ekzistuese në arsim. Në rend të dytë për atë çka ekziston mund të shtonim se Qeveria do të angazhohet për profesionalizimin e profilizimin e shkollave të mesme, Qeveria do të ruajë dhe promovojë autonominë e Universitetit sipas standardeve ndërkombëtare, pastaj do të shtonim se Qeverija do të sigurojë mbrojtje ligjore për liritë akademike do të nxis aftësitë konkurruese në arsim, do të stimulonte hapjen e drejtimeve deficitare në Kosovë dhe do të ndante një buxhet të veçantë për veprimtaritë shkencore. Ajo që mungon në program dhe duhet të shtohet janë: këto pika, në rend të parë se Qeveria do të angazhohet për hartimin e strategjisë së zhvillimit të sistemit arsimor në Kosovë, pastaj Qeverija do të siguroj bazë ligjore që ruan dinjitetin e njeriut të arsimit dhe shkencës, raportet midis mësimdhënësve dhe nxënësve, respektivisht studentëve.

Do të shtohet se Qeverija do të nxisë bashkëpunimin e institucioneve arsimore me organizatat joqeveritare që merren me çështje të arsimit, në veçanti do të koordinojë dhe bashkëpunojë aktivitetet me sindikatat e arsimit dhe të shkencës në Kosovë. Do të mund të shtohet se Qeveria do të stimuloj bashkëpunimin e institucioneve të arsimit me institucionet ndërkombëtaresimotro simotra, pastaj Qeveria do të bashkëpunojë me institucionet arsimore dhe shkencore duke i angazhuar ekspertët e tyre për punët e Qeverisë, mund të shtonim se Qeveria, mendoj se është pikë mjaft me rëndësi, do të angazhohet për depolitizimin e arsimit dhe do të ndalojë aktivitetet politike, partiake brenda objekteve arsimore, dhe në fund mendoj se i mungon trajtimin të këtij programi çështja e edukatës fetare ,edukatës qytetare, edukatës seksuale, dhe të çështje tjera. Duke mos dashur që të dal në tërsi nga ky projekt, po shfrytëzoj rastin që si deputet të kërkoj nga kryeministri që në seancën e ardhshme të Kuvendit të Kosovës, të ofroj një raport për vizitën e tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në mënyrë që raporte të tilla për udhëheqësit dhe përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës të jenë dukuri. Ju falënderit.

Z. HYDAJET HYSENI, para se ta merr fjalën deputeti i ardhshëm, dua t' ju njoftoj se për diskutim janë paraqitur edhe 26 deputetë, duke pasur parasysh edhe kohën, duke pas parasysh edhe kohën kjo do të na marr shumë kohë, prandaj duhet të merremi vesh ose të reduktojmë mundësisht diskutimet, me mundësi që të ketë edhe tërheqje prej diskutimit aty ku konsiderohet se janë përsëritje, meqë duhet edhe kohë, për pauzë dhe për përgatitjen e përgjigjeve të Qeverisë ose propozimi që po thuhet për të vazhduar nesër, mirëpo ne kemi menduar se mund të përmblihet edhe sot me kushtin që përmenda.

Fjalën e ka **Z. ALUSH GASHI**,

E ndruara Kryesi, i nderuari kryeministër dhe anëtar të kabinetit. Edhe me këtë rast përkujtojmë rëndësinë e jashtëzakonshme të Bashkësisë Ndërkombëtare në prosperitetin e gjertanishëm të Kosovës, dhe dëshirën për një bashkëpunim sa më efektiv. Me këtë rast që në fillim përgëzoj kryeministrin dhe kabinetin, i cili ka provuar ta bëjë një sublimim të nevojave të qytetarëve të Kosovës, dhe posaçërisht në respektimin dhe garantimin e të drejtave njerëzore dhe kombëtare si dhe krijimin e kushteve për një prosperitet të qytetarëve të Kosovës si garantues të paqes dhe stabilitetit në rajon. E tëra që zhvillohet sot është një rrethanë jashtëzakonisht fatlume, është një përpjekje e një pune vetmohuese me dekada të qytetarëve të Kosovës, fatmirësisht politika e qytetarëve të Kosovës, e në veçanti e njerëzve të zgjedhur të Kosovës, është bashkëpunimi, argumentimi, jo nënshtrimi dhe konfrontimi.

Prandaj, mendoj se është shumë me rëndësi, që ky debat të jetë sa më i gjithanshëm dhe më konstruktiv. Një nga porositë e Programit të Qeverisë së Kosovës është dëshira për një prosperitet dhe garantim të drejtave njerëzore dhe kombëtare, për të gjithë qytetarët e Kosovës është një porosi e cila meriton një respekt të posaçëm dhe ka mbështetjen time. Ajo çka eventualisht është e domosdoshme të përfshihet është se liria është e plotë. Nëse ajo liri është e përcjell me përgjegjësi të plotë të njerëzve të zgjedhur, gjë e cila deri në këtë fazë nuk është në institucionet e Kosovës e përfshirë në programet e saj, mendoj se Qeveria e Kosovës ka hapsirë dhe ka mandat që në kuadër të kompetencave të pakontestueshme të përfshijë çështje në të cilat Kosova ka një memorie institucionale shumë të lakmueshme e që është bashkëpunimi ndërkombëtar. Mendoj z. kryeministër se

politika e jashtme e Kosovës zhvillohet nga kryetari i Kosovës, në bashkëpunim me përfaqësuesin special, ndërsa infrastrukturën, respektivisht bashkëpunimin ndërkombëtar të Kosovës me botën duhet ta përgatis dhe ta menaxhoj Qeveri e Kosovës. Edhe në kohë shumë më të vështira, Kosova ka ofruar një shërbim për qytetarët e saj jashtë Kosove. Kosova ka një përvojë të dhjetëra zyrave për ofrim të shërbimeve të qytetarëve të saj, kjo nuk është shkelje në kompetencat e përfaqësuesit special, e as në kompetencat e komunitetit ndërkombëtar, i cili është tash. Unë mendoj se ky program do të miratohet sot me një mundësi plotësimi në komisione përkatëse, ku komisionet përkatëse do t'ju mundësojn ministrave që të vijnë dhe ta elaborojnë, respektivisht ta detajizojnë programin e vet. Është një përcaktim i fuqishëm i shoqërisë kosovare, bashkëpunimi dhe jo konfrontimi. Kur bisedohet për bashkëpunim dhe jo konfrontim, kam parasysh një prej çështjeve më të rëndësishme sot në Kosovë, e që është çështja e sigurisë. Për çështje të sigurisë në Kosovë debaton Këshilli i Sigurimit, debaton Unioni Evropian, miratohen rezoluta në Kuvendin e Kosovës, z. kryeministër ne kërkojmë nga ju që në kuadër të kompetencave të keni një program të sigurisë, të cilin jua ofroni atyre të cilëve jua ofroni atyre që sot për sot i kanë të rezervuara kompetencat. Mendoj se administratori i tanishëm do të jetë sigurisht administratori i fundit në Kosovë, para zgjedhjes së statusit final të cilin shumica dërmuese e njerëzve të zgjedhur në Kosovë e prejjudikojnë Ne jemi të bindur që ajo do të jetë pavarësia e Kosovës. Ju falënderit,

Fjalën e ka Smilka Milisavlevdiq, kërkoj falje që se njoftuam me kohë, dhe le të përgatitet z. Arsim Bajrami.

Z. SMILKA MILISAVLEVIQ,

Poštovana gospodo. U svome izlaganju i komentaru na ekspozice želim da jednim segmentom Programa Vlade, odnosno tačkom tri koja glasi postizanje evropski standard u obrazovanju, u kojoj su izneti prioriteti Vlade po pitanju osnovnog, srednjog i visokog obrazovanja. Želim da naglasim da je obrazovanje najača je sektor u smislu izgradnje identiteta, i da mi važnosti u ekspozeu mandatara nije po..... adekuatna pažnja, veoma su iznesente ključne tačke angažovanja Vlade, to su bazirane na

jedinstvenom obrazovnom sistemu, i postizanje evropski standard na svimnivoim obrazovanja, takođe je isteknuta berza prenos u odgovornosti za osnovno i srednjo obrazovanje na opštinske i njihove vlade kao i napor za obezbeđivanje donacija koja bi bila za poboljšavanje u infrastrukturi, međutim kao osnovno želim da naglasim , da u programu obrazovanja lokalnih zajednica u opšte nije razmatrano a samimtim i određeni specifičnosti karakteristično su za zajednice . Zato smatram nužnim da Vlada u svom Programu mora da uvaži činjenicu, kada govori o razvoju plana i programa , da taj razvoj uprilagodi potrebima i interesima svih zajednica. Vlada takođe mora da se pobrine da škole lokalnih zajednica zaista dobiju sredstva koja su im dodeljena , kao i nastavnici lokalnih zajednica budu uključeni u svim programima obuke, u pogledu serbske zajednice, sobzirom da je veliki deo serbske popullacije u raselenju a u cilju pospešivanja kontakata potrebno je obezbediti razvoj nastavnog plana u skladu sa tekućim procesima reforme u Srbiji, znači sinhronizaciju reformi i kontabilnost Programa. I na kraju želim da naglasim kao osnovno da Vlada mora izneti stav u Programu po decentralizaciji odnosno u skladu sa reformama dozvolite autonomiu na najnižem nivou u cilju određivanja obrazovnog procesa. Hvala.

Z. ARSIM BAJRAMI, pas tij Tom Hajdaraj,

Z. ARSIM BAJRAMI,

E nderuara kryesi e punës, i nderuari kryeministër, të nderuar ministra, të nderuar deputet. Mendoj se para nesh ndodhet një program mjaft real i Qeverisë së Kosovës, i cili përmban objektivat gjenerale dhe që janë të mundëshme duke pasur parsysh edhe kompetencat ligjore të Qeverisë së Kosovës. Kur e them këtë nuk e përjashtoj nevojën që çdo ministri e Qeverisë të ketë programe të veçanta që të jenë shumë më konkrete dhe të përmbajnë objektivat konkrete. Mendoj se Qeveria ka zgjedhur një metodë të mirë të punës duke mos premtuar të pamundshmen, por duke premtuar ate që për momentin mund të realizohet dhe mendoj se një logjikë të këtillë duhet përshëndetur, meqenëse ne e djmë që Kosova në fazën e parë të qeverisjes së përkohshme nuk do të jetë e përkufizuar me faktin se vetëm një pjesë e përgjegjësive transferohen te organet e

vetqeverisjes së përkohshme, dhe mendoj se ky program që kemi përpara i është adaptuar këtyre kompetencave që ka Kosova. Unë mendoj se Qeveria do të jetë e gatshme që pas një periudhe njëvjeqare të vijë përsëri në Kuvend dhe të prezentoj një program të ri, me kompetenca të reja që do të transferohen në proces, meqenëse siq e dini vet fryma e administrimit ndërkombëtar është bartja progresive e kompetencave kështu që për momentin Qeveria ka vepruar mirë për shkak se ka ofruar programin me objektivat e qarta dhe të mundëshme që kanë bazë ligjore dhe juridike. Natyrisht, programi nuk është i përkryer, nuk është ideal, por përmban edhe njëherë po ju them objektivat shumë reale të cilat po ju them me siguri se me kohë do të plotësohen dhe do të korigjohen. Unë këtu do të flas edhe në cilësinë e kryesuesit të Komisionit për çështje legislative dhe kushtetuese dhe do të shprehi qëndrimet e këtij Komisioni dhe do të marrë pak kohë duke folur për programin në sferën e arsimit të edukimit dhe shkencës .

Duke pasur parasysh se të gjitha kompetencat e Qeverisë do të realizohen dhe komplementohen nëpërmjet një pakete ligjdhënëse, mendoj se Qeveria ka ofruar një paket mjaft ambicioz ligjdhënëse duke propozuar mëse 50 ligje, sipas kushteve të ndryshme, në bazë të apo në bazë të agjendës që e ka propozuar. Mendoj se kësaj agjende siç tha edhe vet kryeministri në fjalën hyrëse do ti bashkangjiten edhe drafte tjera të ligjeve që do të propozohen nga subjekte tjera të autorizuara për të propozuar ligje, pra nga vetë komisionet dhe vetë deputetët në mënyrë që Kosova gjatë kësaj periudhe të kompletojë sistemin e vet juridik me ligje të reja që këtu s'janë përfshirë, duke parë agjendën e këtyre ligjeve, në emër të Komisionit për çështje legislative dhe kushtetuese i propozojmë kryeministrit dhe anëtarëve të Qeverisë që të rishqyrtojnë këtë agjend dhe me prioritet ti propozojnë Kuvendit të ashtuquajtura ligjet organike apo sistimore , të cilat në një mënyrë do të ndërtojnë një sistem të ri juridik në Kosovë dhe do të krijojnë një të drejtë të re pozitive në Kosovë. Në këtë drejtim i propozojmë që me prioritet ti marrë parasysh disa ligje sistimore të cilat që tani janë të gatshme , të cilat tani kanë marrë edhe pëlqimin e Këshillit të Evropës dhe që janë punuar mëse 2 vjet e ashtuquajtura pakoja e ligjeve penale që përbëhet nga 5 ligje, nga ligji penal, Ligji i procedurës penale, Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, ligji për të mitur dhe Ligji për kundërvajtje .

Unë mendoj se këto ligje pas ligjeve për sferën e arsimit, të cilat i propozoi kryeministri duhet të kenë prioritet në Qeveri, meqenëse gjendja ekzistuese në gjyqësinë e Kosovës është e pakënaqëshme duke pasur parasysh se këto gjykata akoma vazhdojnë të punojnë me legjislacione të vjetra, me legjislacione të shteteve të huaja dhe me legjislacione që janë të ngarkuara edhe në pikëpamje ideologjike. Është nevojë e domosdoshme që sa më parë ky Kuvend të adaptojë këto ligje në mënyrë që të lehtësojë edhe punën e gjyktave dhe gjykatat pastaj të punojnë me ligje të reja, të cilat edhe njëherë po e përsëris duhet të jenë në pajtim të plotë me standardet e Këshillit të Evropës. Një çështje që dëshiroj të ngris që është shumë me rëndësi për Qeverinë është çështja e mënyrës se si do të përgatiten këto ligje, si do të adaptohen dhe si do të prezentohen Kuvendit të Kosovës. Unë i propozoj Qeverisë që këto ligje të mos hartohen në kabinete, në kabinete të Qeverisë apo ministrive por të kemi këtu një transparencë. Mendoj se edhe për Qeverinë do të jetë i mirëseardhur një shoqërim i procesit të njerrjes së ligjeve dhe një transparencë duke kërkuar mendimin e opinionit profesional dhe shkencor, dhe mendimin e subjekteve të interesuara për ato ligje. Nuk është mirë që ministrat të na bien ligjet nga kabinetet e tyre, por do të propozoja që Qeveria të ndjekë një praktikë që të marrë opinionet, jo vetëm të strukturave profesionale, por edhe opinionet e shoqërisë civile, meqenëse ne dëshirojmë që këto ligje vërtet të jenë të qëndrueshme.

Në anën tjetër mendoj se Qeveria duhet edhe të ketë bashkëpunim institucional me strukturat shkencore që aktualisht janë në Kosovë, me institutet shkencore, por edhe me strukturat e universitetit të Kosovës. Sa i përket sferës së arsimit, unë mendoj se kemi një program mjaft reduktues, duke pasur fatin se ky program është pjesë e programit të Qeverisë. Unë mendoj se Ministria e Arsimit duhet të ketë një program të veçantë. Unë angazhohem që Qeveria vërtet dhe seriozisht të marrë në shqyrtim pozitën materiale të arsimit dhe para vitit të ardhshëm akademik të dal me një zgjidhje e cila do të përmirësonte këtë pozitë vërtet të pakënaqëshme në arsim. Tani po shifni që nga arsimi kosovar, në të gjitha nivelet, po kërkohen reforma evropijane, ndërsa pagat e profesorëve, jo që nuk janë evropiane por ato as nuk stimulojnë kenë për reforma. Në anën tjetër, reforma në arsim duhet të jetë shumë e kujdesshme, dhe e haretuar me kriteret profesionale, për shkak se arsimi është shtylla kryesore që përgatit kuadra dhe për

mirëqenie të përgjithshme, duke pasur parasysh se në një nga seancat e para do të kemi draftin për diskutimin e dy llogjeve sistemore, ndoshta ligjet më të rëndësishme për këtë fazë, ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm, dhe ligjin për arsimin e lartë. Unë do ti sygjeroja Qeverisë që në procesin e hartimit të këtyre ligjeve të kyqen edhe ekspertët vendorë, me qen se ato drafte të cilat i posedon Ministria e arsimit janë përpunuar ekskluzivisht nga ekspertët ndërkombëtar, dhe përkundër zgjidhjeve të avansuara nuk kanë marrë parasysh specifikat e Kosovës dhe realitetin e Kosovës. Do të ishte mirë që të kemi një çasje të ekspertëve kosovarë, në mënyrë që të jemi të sigurtë që po bëjmë disa ligje të qëndrueshme, të cilat do të jenë bazë për formimin e tërësishëm të arsimit kosovar, Ju falënderit.

Z. HYDAJET HYSENI, tërheq vërejtjen që të kemi kujdes që të respektohet koha e paraparë për arsye që e tham pak përpara.

Z. TOM HAJDARAJ, le të përgatitet, këtu me radhë është Bajram Kosumi, por meqë nuk është këtu, le të përgatitet deputeti Samarxhiq Sfetomir.

Z. TOMË HAJDARAJ,

Kryesi e nderuar, i nderuari kryeministër, kolegë deputetë. Unë para se t' i jap vërejtjet e mia në pjesën agrare të programit, për hirë të opinionit z. nga Dardana i cili në diskutimin e tij tha që pas ardhjes së forcave të NAT-os blegtorial, gjegjësisht fondi blegtoral është shkatërruar nga shqiptarët, nuk është ashtu, për arsye se fondi blegtoral dhe bujqësia në tërësi, pas faktorit njeri ka qenë e atakuar 10 vitet e fundit e posaçërisht pas vitit 1996, me rastin e inskenimit të afta episodikes ku si shkak i kësaj janë eliminuar 4200 krerë lopë qumshore në Kosovë. Mirëpo, falë punës së madhe të Këshillit republikan të atëhershëm për bujqësi, të kryesuar nga prof. Dr. Hamdi Gashi, i cili u vra nga forcat barbare, u vërtetua që nuk është e vërtetë jo, dhe se asgjatë ishte ajo vetëm për hirë të karakterit politik, mos të them të programit afatgjatë dhe të kahmotshëm. Nëse ka nevojë unë e kam materialin e vlerësimit të dëmeve të vitit 1996 deri në vitin 1999 në krejt sferën e bujqësisë, sipas kategorive, shprehur në marka të cilat fatkeqësisht kapin

një shumë katastrofike, për hirë të opinionit e kam këtë dhe nuk është e vërtet atë që e thot z. I. minoritetit serb nga Dardana. Po tash jap vërejtjet e mia z. Kryeministër, para jush me qenë se banka është e zbrazët e ministrit të bujqësisë, dhe dhashtë zoti që ajo të plotësohet dhe të mos politizohet, e kam than edhe dje, por në propozimin e vërejtjeve tona si Komision po e them tash si ekspert se ne si komision ne ende nuk jemi ulur, mu për këto shkaqe, do të ulemi të hanën, por sot kam ba disa sygjerime dhe vërejtje. Në radhë të parë, duhet të parashihet strategjia trivjeçare e Ministrisë së Bujqësisë. Libri i gjelbërt, në të cilin do të hyjnë të gjitha prioritetet, informatat për preriudhën para dhe pas luftës, në të gjitha degët e bujqësisë, informata emergjent të lopëve qumshtore, informata mbi prodhimtarinë ditore të çumshtit në Kosovë, konsumit të importit të këtij artikulli shumë të rëndësishëm, standardizimi prej prodhimit të qumshtit, gjendja shëndetësore momentale e kafshëve, inspekcioni kufitar i pambuluar, gjendja e shpezëve d.m.th. konsumi ditor i veve, prodhimi ditor dhe importi ditor, informata mbi therretoret komunale, inspekcioni veterinaro-sanitar dhe fito sanitar për kontroll të brendshëm, informatat mbi karantinat momentale të kafshëve të importuara, gjendja në pylltari e cila sipas vlersimeve tona nuk është fare e kënaqshme, hidroekonomia, shfrytëzimi i ujërave në bujqësi, posaçërisht e hidrosistemit Radoniq dhe Ibër, dhe në sistemet e vjetra, gjendja në të ashtuquajturën pronë shoqërore, ku e njehta përfshinë 10% të sipërfaqeve bujqësore si dhe linjat e prodhimit, d.m.th. që kemi fabrika të ndryshme, gjendja në vreshtari dhe pentari, statistika e strukturës mbjellëse të sipërfaqes tokësore të Kosovës, pjesa e rregullimit të tokave përmes riparcelimit dhe komasacionit, rregullativat ligjore në të gjitha lamitë e bujqësisë. Duhet pasur parasysh prioritetet e tyre në aprovim, privatizimi i ndërmarrjeve bujqësore, si dhe i tokës të ashtuquajtur shoqëror, krijimi i qendrave informative për tregun e produkteve bujqësore, ushqimore, Banka e bujqësisë, gjegjësisht Banka e gjeneve e cila shërben për ruajtjen e origjinalitetit dhe për përfitimin e linjave të reja, autoktone të Kosovës dhe dhashtë zoti që do të kemi nga përfitimi i farës e deri te kategoritë e pastra gjenetike të kafshëve, subvencionet në bujqësi, qendrat grumbulluese të artikujve bujqësor. E dini fare mirë që bujqit tanë prodhojnë por nuk kanë fare ku të grumbullojnë, d.m.th. mbrijnë shkallën e nervozës duke pasur parasysh importin më të lirë nga shtetet fqinjë, prioritetet e mbjelljes së kulturave industriale, kreditimi i farmerëve dhe i repromaterialit, taksat për artikuj final bujqësorë, d.m.th. patjetër aty

duhet të jemi të prerë, sigurimi i prodhimeve nga shteti, sidomos kur kemi të bëjmë me fatkeqësitë elementare. Sa ju përket ligjeve në bisedë që kemi pasur me shërbimet profesionale, të cilat veprojnë në Ministrinë e Bujqësisë së Kosovës, ne sipas tyre kemi marrë informata që disa prej tyreju falënderit.

Z. HYDAJET HYSENI,

Një sygjerim. Ata që kanë far ndihmesash me shkrim mund t'i paraqesin edhe me shkrim dhe mund t'ju hyjnë në punë. Mos të shkojnë nëpërmes sekretariatit të Kuvendit Fjalën e ka deputeti Svetomir Samargjiq, le të përgaditet Exhlale Salihu.

SVETOMIR SAMARDŽIĆ,

Uvaženi presedavajući, uvaženi Predsedništvo, dame i gospodo narodni poslanici. Ja ću danas govoriti o jednoj društveno posebno značajnoj delatnosti više sa aspekta struke organizacije nego sa aspekta politike. Zdravstvo kao delatnost i zdravlje koja nas štiti i unapređuje su uopšte pri vrednosti hvaćene i niko ne bi trebalo da ima pravo da njen politički manipuliše. I u najtežim trenucima koji su se koliko juče događali svim stanaovnicima Kosova i Metohije, narod je govorio samo zdravlje, na nesreću svih nas mnogih njih više nema među živima, drugi su oboleli od fizičkih i mentalnih obolenja, a mnogi danas pate a nemaju mogućnosti da se uspešno leče.

Gospodine premijere, Rezoluciju koju ste izdali veoma pažljivo sam pročitao, moji su kolege poslanici dakode analizirali obradili i ocenili sa svoje tačke gledišta. I u tome su dali svoja mišljenja, ja ću govoriti samo o tački pet o riorganizaciji reforma zdravstvenih sistema na Kosovu i Metohiji. Globalno gledano sasvim podržavam ovo poglavlje i smatram da sasvim predstavlja mali embrion ka savremenim težnjama ka evropskim kretanjima koji n esumnjivo i mi na Kosovu i Metohiji težimo. Veoma ste dobro uočili da su indikatori zdravstvenog stanja stanovništva na Kosovu i Metohiji na najnižim stupnjama u Evropi, ja vas uveravam da ja to odlično znam i da čitav svoj radni vek sam sa velikim zadovolstvom radio sam na suzbijanju mnogih teških epidemija na Kosovu i Metohiji koja savremena Evropa već davno nema. Smertnost

toga je zahvaljući celje zajednice u kojoj smo živeli i naporima i velikim entuziazma zdravstvenih radnika svih naroda i narodnosti na Kosovu r apidno padale , procenat uspešno minimizovan je rastao do željenih granica, stavilismo već deo vodovoda pod zdravstveni nadzor i kontrollu, a onda već došlo do zastoja i njegovog verhunca bombardovanje naše zemlje od strane NAT'-o trupa. Da nisu mogli ili nisu znali drugačije da nam pomogu ne osuđujem ali mi smo tu gde smo. Vaša Rezolucija g. premijeru, bih imao pun smisao da ne bi bilo bombardovanja i egzodusa i jednog i drugog naroda zaista podržavam proces riorganizacije zdravstvene službe, ali tražim da dopunite u smislu akutnih nestalih potreba stanovništva za zdravstveno zaštitu. Vi morate g. premijeru p potrebama s tanovništva a ne bežati o d njih. i u n akon bombardovanja dosa urošavanja zdravstvenog sistema, jedni se veoma berzo oporavilih a drugi i danas nemaju osnovne principe zdravstvene zaštite i nisu dostupni . Postojeća situacija može se lako zaključiti analizom da nam je neophodno u enklavama gde žive Srbi obezbediti dostupnost, odnosno fizičko postojnje zdravstvene uslova i osobljana kome Vlada Srbije i UNMIK u zadnje vreme stabilizuje stanje, zatim pristupačnost to znači da stanovnici moći da koriste zdravstvenih usluge da savladaju udaljenost zdravstvenih usluga i da mogu da plate put do tih zdravstvenih ustanova –Vakcinacija dece ide jako otežano, zaština kao poseban pokazatelj u zdravstu je skoro nemoguća, mislim da ćete se složiti da od dostupnosti hitne pomoći se ne može ni govoriti a vodosnadbevanje je improvizovano, zaključujem da nas prete velike epidemije, ja ću sasvim skratiti molim vas gospodine premijeru molim da se ova Rezolucija dopuni sa aktuelnom nastalom situacijom u zdravstvenom sistemu je krajnja odgovornost pasti na Vladu Kosova i Metohije. Hvala.

Z. HYDAJET HYSENI, fjalën e ka deputetja Exhlale Salihu, kurse le të pregaditet z. Fetije Kpuska.

Z. EXHLALE SALIHU,

E nderuara kryesi, i nderuari kryeministër,të nderuar ministra, të nderuar kolege deputete dhe deputetë. Jam shumë e nderuar që kam rastin të diskutoj për programin e Qeverisë

së Kosovës, dhe e votoj me kënaqësinë më të madhe. Si çdo projekt, si çdo punë që nuk është absolute, do të thotë që nuk është e përkryer, edhe kjo nuk është e përkryer. Duhet ta dijmë dhe ka hapsirë për diskutime të vazhdueshme. Po mendoj u diskutu mjaft dhe do të jem shumë e shkurtër. Do të ndalem te ajo që mu më takon te arsimit dhe shkencën. Ate që duhet me thanë e tha z. Kuqi, kryetar i Komisionit për arsim dhe shkencë, dhe unë vetëm shkurt do të shtoja diçka lidhur me shkencë. E para që më ra në sy, është ajo arritja e standardeve evropiane në arsim. Ne kemi Ministrinë për Arsim Shkencë dhe Teknologji, dhe këtu nuk po e shoh emrin shkencë, do të thotë një pjesë e atyre që arsimohen merren me shkencë. Unë faktikisht jam e mendimit që ta gjejmë një hapsirë dhe të gjejmë një mundësi që të vëjmë emrin shkencë, nuk kam ide konkrete si ta përcillojmë këtë titull, mirëpo është e mundëshme që të themi kështu, arritja e standardeve evropiane në arsim dhe shkencë, do të thotë ta vëjmë emrin shkencë. D.m.th kjo ishte për të parën, mandej lexoj në faqën tjetër d.m.th pas titullit në fund, d.m.th. paragrafi i fundit lidhur me këtë problematikë, Qeveria do të inkorporoj regjenerimin e instituteve shkencore dhe do të nxis dhe stimuloj punën shkencore në të gjitha lëmitë, nuk e kam të çartë çka është regjenerim, regjenerim i punës së institucioneve, regjenerim i rritjes së numrit të instituteve shkencore, apo regjenerim i kuadrit shkencor, do të thotë do të ishte kështu Qeverija do të përkrah unë sygjeroj Qeverija do të përkrah veprimtarinë institute të tanishme shkencore, dhe shtimin e numrit të tyre sipas nevojës, si dhe diçka çka është shumë me rëndësi e kët e pash vetëm te arsimi. Thuhet kështu në mënyrë të vazhdueshme do të punohet për ngritjen e niveleve të kualitetit të mësimdhënies, si dhe përmirësimin e menaxhimit të buxhetit të arsimit. Unë këtë të njejtën e kisha fut te shkencën dhe kisha thanë të buxhetit të shkencës, se edhe shkencën me të vërtetë përfshin shumë fusha. Keni fushën e parë të hulumtimit, keni fushën studimore që do të thotë ajo materie që është hulumtuar duhet të studiohet, dhe fushën e prezentimit, që do të thotë ajo që është hulumtuar dhe studiuar duhet të prezentohet nëpër simpoziume dhe kongrese shkencore. E ju e dini që në periudhën e okupimit dhe të administratës së dhunshme 10 vjeçare ka njeri që se ka pa Shkupin e lenë ma ta përfaqësoj Kosovën me punime tona shkencore. Këto ishin ato esenciale, për buxhetin e veçantë të Kosovës e tha edhe z. Kuqi, mirëpo unë e shtova këtë që të jetë e veçantë. Ka edhe gjana tjera, mirëpo kjo ishte esencjalja, pra Ju falënderit.

Z. HYDAJET HYSENI, fjala i jepet deputetes Fetiye Këpuska, kurse le të përgaditet deputeti Vujishiq Sveta.

Z. FETIJE KPUSKA,

Enderruara kryesi para se t'i shfrytëzoj 5 minutat e mi kisha pasë një lutje dhe asaj lutje ia bashkangjes propozimin: deputeti që u përmend nuk është këtu le të përgaditet Mirishahe Hulaj. Më falni vazhdoni, të kemi një mirëkuptim rreth barazisë gjinore në ftesën e deputetëve që shprehin mendimin e tyre të lirë. Tash na tha edhe OSBE-ja që duhet me qenë njëloj, vërtet sygjerimet e mia kishin me qen të pikës 5 rreth reformave shëndetësore. Në mungesë të ministrit të shëndetësisë, ndoshta edhe pyetjes më vonë, ky program që është paraqit është sa pak skeptik ndoshta meqë nëse është marrë si përshkrim ndaj të punuara dy librave që janë punuar në ish Departamentin, dy libra të kaltërta dhe një e verdhë. Po e citoj atë në fund që thotë se Qeveria do të vazhdoj të implementoj Programin e hartuar nga Departamenti i Shëndetësisë, unë mendoj se në këtë ngritje politike që Kosova ka mbërrit me institucionet e veta, Ministria duhet të punoj duke punuar me grupet punuese, me institucionet shëndetësore në rajon, ku duhet të përfshihen të gjitha nevojat dhe kërkesat e popullatës tonë, meqë edhe programet politike kanë prioritetet e veta, sidomos në shërbimin primar ku ka mangësi mjaft, mandej janë prioritetet e popullatës ku janë e posaçërisht duhet të potencohen familjet e dëshmorëve, mandej invalidët e luftës, shërbimet për ta duhet të jenë ma të, të nivelit ma të lartë duke mos participuar. Mandej kemi gratë kryefamiljare, mandej janë lehonat dhe fëmijët, ka edhe shumë e shumë gjëra që me siguri për pesë minuta nuk mund të përfshihen. Po ajo çka mund të përfshihet është edhe se Qeveria thot se do të zhvillojë sektorin edhe për miratimin dhe dhanjen e barnave nga ajo pjesë. Unë përsërisht është edhe lista esenciale e barnave e cila fare nuk funksionon në institucionet shëndetësore dhe shumë kolegë këtu e dijnë se çka do të thotë liste esenciale e barnave. Ka pasur mjaft barna apo medikamente të dërrëguara nga organizatat ndërkombëtare të cilat deri në muajt e fundit kur kanë skadur nuk kanë dal në shitje dhe ma vonë janë gjetë në farmacitë tona. Dhe çka më pastaj. Ato edhe shiten, apo në farmacitë tona nuk ka respekt të

përshkrimit të barit që pacienti mundet të marrë barin e mjekut vetëm me përshkrimin e reçetës, në farmacitë tona mundet çdo individ të hyjë dhe të marrë prej një vitamine të thjeshtë e deri te një qetsues më i ndoshta edhe me kontraindikacione. Po them se ka edhe mjafte mjafte me si guri se 5 minuta kanë kaluar, por çka kishte me qenë që vet departamenti. Nëse miratohet kjo politikë, atëherë do të mesin jashtë pa e përfshi vërtet shërbimi primar, sekundar dhe ai terciar. Ritrajnimet, trajnimet e punëtorëve shëndetësore, si brenda vendit poashtu edhe jashtë vendit, kualifikimet e tyre më të larta, por mos të harrojmë se duhet të kemi të mirfillit shërbimin primar me kontrollera sistematike duke filluar prej shkollave fillore e deri te arsimit më i lartë por edhe nëpër institucione, nëpër fabrika ku ka shumë të punësuar. Mandej rreth përpilimit të reformave në arsim edukata shëndetësore është shumë e domosdoshme, edhe në arsimimin fillor, atë të mesëm dhe universitar. Kur flasim për një kulturë, atëherë duhet të kemi nivelin e ngritur edhe në edukimin shëndetësor. Me këtë të përfshihet shërbimi primar, të potencohet në qendrën familjare atë që e ka bërë organizata botërore e shëndetësisë dhe ish Departamenti. Unë në emër të kolegëve, besoj që edhe ata të profilit tim e ndajnë këtë mendim, por edhe jashtë Parlamentit janë sado të cenuar, shërbimi i mjekësisë familjare përveç se e ka ndërruar emrin në Qendër familjare asgjë tjetër nuk është bërë, aq ma tepër që qasjet e popullatës në shërbimet shëndetësore janë edhe ma të zvogëluara. Nëse ata duhet të trajtohen ata duhet vet të blejnë prej shiringut plastik që nevojitet të trajtohet, Ju falënderit.

Fjalën e ka deputetja Nurishahe Hulaj, ale të përgaditet z. Sala Ahmeti.

Z. NURISHAHE HULAJ,

E nderuara Kryesi, e nderuara Qeveri, të nderuar deputetë, pasi që edhe une jam mjekë, nuk do të përsëris gjërat që i përsëriti kolegja jonë, por do të cekim disa indikatorë që është dashtë të cekim në Programin e Qeverisë, si p.sh. nuk e vërejtja inicimin e një ligji qëllimet dhe prioritetet e kësaj që unë nuk i vërejtja në programin e Qeverisë që është prioritare, duhet të jenë gjanat e afatizuara, sepse për revaluimin e programit të Qeverisë ne duhet të dijmë afatin e në bazë të revaluimit ne duhet të dijmë se sa kemi arrijt ne në

realizimin e programit. Mendoj se është një indikator shumë i rëndësishëm dhe mendoj se duhet të futet dhe se ka vend të futet edhe ky indikator. Edhe një gjë tjetër shëndetësia shkencore, kërkimore edhe kjo nuk ishte cekur në programin e Qeverisë, indikator tjetër sistemi informativ shëndetësor që është një indikator shumë i rëndësishëm, për shëndetësinë kosovare, i cili indikator është cekur edhe në strategjinë shëndetësore të Kosovës të dal në shkurt të vitit 2001, një indikator shumë i rëndësishëm sepse në bazë të të dhënave informativo shëndetësore të Kosovës, ne mund t'i japim kahjet e zhvillimieve shëndetësore në Kosovë. Edhe një indikator tjetër shumë i rëndësishëm për të cilin kanë punuar shumë edhe organizatat jo qeveritare dhe na kanë ndihmuar në këtë drejtim është shëndeti mental që do të implementohet në kuadër të mjekësisë familjare. Mendoj se ka vend edhe për këtë që të futet në programin fillestar të Qeverisë së Kosovës dhe e përshëndes unë atë program, por mendoj se ka vend që në të ardhmen të plotësohet, Ju falënderit.

Fjalën e ka Sala Ahmetaj, le të përgaditet Naim Jerliu.

Z. SALA AHMETAJ,

E nderuara kryesi, i nderuari kryeministër, të nderuar ministra, të nderuar deputetë, edhe unë kam nderin dhe kënaqësinë që më është dhënë rasti të flas për programin e Qeverisë të cilin e kemi para nesh. Unë do të ndalem vetëm për një çështje, për të cilën mendoj se jam pak më kompetente, në programin për kulturën të cilin e kemi përpara, kujtoj që përveq vërejtjeve tjera që i dhanë kolegët, unë do të shtoja edhe disa çështje. Kujtoj se Ministria e Kulturës e Kosovës si përparësi themelore duhet të ketë faktin dhe duhet të ketë parasysh se në Kosovë është duke u bërë një akulturim dhe kjo është shumë e dhimbshme për ne, prandaj në këtë program do të dëshiroja që të zinte vend kjo çështje, shundi po e pushton gjithandej Kosovën. Kujtoj se kjo e keqe e madhe e jona mund të ndalet vetëm në qoftë se ministria përkatëse do të dij ti çmojë vlerat dhe do të dij t'i luftojë antivlerat, madje në qoftë se nuk ka mundësi tjera, duke i sanksionuar me ligj P.sh. çështja e gjuhës. Gjuha dhe emri janë elementet e para të identitetit kombëtar, janë vlerat më të rëndësishme. Ne jemi dëshmitarë të faktit se gjuha shqipe është duke u

zhbërë, dhe po zhbëhet dhe po dhunohet pamëshirëshëm. Secili komb që synon të jetë i pavarur duhet të ketë edhe një gjuhë standarde. Shqiptarët e kanë gjuhën standarde, por ajo nuk po përfillet kënaqëshëm, madje as në këtë Parlament, vetë fakti se dokumentet na sillen të palektuar dhe me gabime të shumta, për të cilën nuk e shoh të arsyeshme të flas, pastaj përkthyesit simultan nuk e përfillin kodin dhe standardin, kujtoj se është e nevojshme të sanksionohet me ligj kjo çështje. Dhe kam një frigë, e këtu do të sjell edhe një shqetësim, sepse në qoftë se vazhdojmë kështu pas 10 vitesh gjuha shqipe do të shëndërrohet në një variantë të shëmtuar të anglishtes. Unë prandaj propozoj që Ministria e Kulturës ta ketë parasysh. Djithashtu ne e dijmë se popujt tjerë janë shumë të ndieshëm për dhunimin kur i bëhet gjuhës. Ta zëmë në Francë ose në Kroaci, këto çështje janë të sanksionuara me ligj. Shpresoj se edhe ne në të ardhmen do ta rregullojmë këtë gjë. Kërkesa ime konkrete është, edhe nëpër zyrat e Qeverisë ku është e nevojshme të pranohen lektorë profesionist e dhe këtu në Parlament përkthyesit dhe lektorët të jenë ekspert dhe të nënshtrohen institucionit të konkursit, e të mos pranohen njerëzit, të cilët nuk kanë njohuri elementare për gjuhën, Ju falënderit.

Fjalën e ka Naim Jerliu, kurse le të përgaditet Gani Koci, ky tërhiqet, le të përgaditet Deputetja Nafije Berisha,

Z. NAIM JERLIU,

E nderuara kryesi, i nderuari kryeministër, të nderuar ministra dhe kolegë të nderuar deputetë, Unë dje kur jam lajmëruar që të marr fjalën, lidhur me programin që na u është ofruar si Program i Qeverisë së Kosovës, kam menduar që të paraqes shkurtimisht ato që janë diskutuar në Komisionin për Shëndetësi dhe tash më duket se janë në favor për faktin se ka pasur disa diskutime pothuaj se të përmbajtjes dhe të esencës që kemi diskutuar në Komision le të më lejohet që shkurtimisht të kaloj edhe njëherë mbi atë çështje që si shqetësimi janë ngritur në Komision, mendoj se duhet të jenë vërejtje të cilat do të adaptohen dhe do të shtohen në Programin e Qeverisë. Ajo që është marrë me befasi nga të gjithë në Komision që sigurisht që edhe ju tjerët që e keni lexuar me vëmendje Projektprogramin e Qeverisë së Kosovës është mungesa në matriksin e ligjeve që pritet

të aprohen në këtë Parlament, mungesa e një ligji mbi shëndetësinë i cili do të rrgullonte funksionimin e sektorit shtetëror, si dhe të sektorit privat, lidhur me shëndetin dhe shëndetësinë nekemi konsideruar dhe konsideroj se është shumë e nevojshme që të ketë e dhe një ligj mbi sigurimin shëndetësor. Gjithashtu në programin e paraqitur në prioritetin e 5 lidhur me reformën e sistemit shëndetësor, më duket se egziston një koncentrim më i madh që ka të bëjë me sektorin e shëndetësisë primare, ndërkaq nuk është një fokus në zhvillimin dhe nevojat e stabilizimit të sektorit të shëndetësisë sekundare dhe të asaj terciare, prandaj ne besojm se ka vend që në Programin e Qeverisë kjo të futet si shtesë dhe në të ardhmen të zbatohet, në mënyrë që të sigurohet një funksionim adekuat dhe një funksionim i sistemit të nevojshëm shëndetësor në Kosovë. Gjithashtu do të duhej që në programin e Qeverisë në veçanti të fokusohet kujdesi institucional shëndetësor për nënat dhe fëmijët, dhe një pikë tjetër e cila do të duhej të jetë në programin për shëndetësi është bashkëpunimi i institucioneve shëndetësore të Kosovës me organizatat ndërkombëtare, dhe aspirata dhe qeverisja e institucioneve të Kosovës t'i integrojë në këto struktura,se procesi i reformave i cili është në zhvillim e sipër, është një proces kompleks dhe dinamik në Komision pashtu është ngritur nevoja që në këtë program të egzistoj një ndarje të realizimit të këtij projekti, të këtij procesi të reformave dhe afatizimit të realizimit të këtyre etapave, kjo do të duhej të bëhet përmes aprovimit të, krahas prioriteteve të cilat janë cekur në Program, të një strategjie nacionale e cila do të mbështetej në parametrat dhe indikatorët që vazhdimisht ndryshojnë në Kosovë, ashtu siç u tha edhe nga kolegët më herët, kjo do të ishte shkurtimisht ajo që është diskutuar, dhe të cilat janë vërejtjet e Komisionit për shëndetësi në Parlamentin e Kosovës, ju falënderit.

NAFIJE BERISHA, le të përgatitet Petković Stojanka,

E nderuara kryesi, e nderuara Qeveri dhe kolegë deputetë. Unë mendoj se Programi i Qeverisë sot ka marrë mjaft komplimente, po edhe disa plotësime e një prej tyre do ta bëjë edhe unë sot, që do t'ia kushtoj pjesës e cila është kushtuar një pjese të punës, punësimit dhe mirëqenies sociale. Në pjesën për punë dhe mirëqenie tek Programi social në faqën 27 dikund të pasusit të dytë ku flet për reformat dhe ritmin e punësimit,

tranzicionin e ekonomik dhe të tjera t'i shtohen edhe këto fjali: Në përfundim të kësaj fjalie atje edhe një regjimi të një tregu të hapur të përshtatshëm për investimet e jashtme dhe vendore t'i shtohet: krahas shpejtësisë së reformave dhe tranzicionit në ekonomin e tregut dhe politika e promovimit të punësimit si dhe shërbimet efektive të tregut të punës që promovojnë punësim, bëjnë pjesë në politikën e shtimit të punësimit në Kosovë, gjithashtu në vazhdim të thuhet, rrjeti i gjërë i qendrave ritrajnuese në Kosovë është krijuar, d.m.th. të ceket sepse kjo veprimtari është duke u kryer në Kosovë për përmirësimin e mundësisë së punësimit të punëkërkuësve dhe të papunëve, pastaj në vazhdim të këtij teksti ku flitet për skemën sociale, të shtohen edhe këto, tek në fund të këtij teksti shtohet edhe kjo: se në kuadrë të ministrisë për punë dhe mirqenie sociale funksionon edhe autoriteti i inspektionit për punë i cili është krijuar për përcjelljen dhe forcimin e zbatimit të rregulloreve ligjore për mbrojtjen për mbrojtjen e punëtorëve në punë. D.m.th. ky inspeksion veç egziston, kështu kishte me qen mirë me u futë edhe në Programin e Qeverisë Në përpjekjet për krijimin e vendeve të punës, dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve Qeveria është për kooperim të ngusht me përfaqësuesit e punëtorëve, dhe punëdhënësve brenda kornizës së institucioneve për dialog social, e posaçërisht me këshillin e tri partive këshilldhënëse, do të thotë të futet në Programin e Qeverisë raporti në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit dhe përfaqësuesve të sindikatës së punëtorëve. Gjithashtu kam disa plotësime në matriksin e ligjeve me prioritet të Qeverisë së Kosovës, unë mendoj se ishte duft të egziston në këtë matriks Ligji mbi metodologjinë për vendosjen e nivelit të pensioneve bazike, si dhe ndër ata më urgjent pasi që siç jam unë e informuar dhe siç kemi informacione kohëve të fundit nga kjo Ministri se ky ligj duhet të fillojë të aplikohet diku pas 1 korrikut që do të thotë se ky ligj është e domosdoshme të dalë dhe këtu para Parlamentit, para fillimit të aplikimit të tij, d.m.th. është shumë urgjent, Pastaj do të duhej në këtë matriks nuk egziston dhe do të duhej të rradhitej dhe ligji mbi skemën dhe asistencës sociale, ligji tash të mos e elaboroj tash çdo njerin ligj veç e veç për shkak se janë disa. Elaborimin do t'ia jap kryesisë së Parlamentit i cili do t'ia dorëzoj Qeverisë, Ligji mbi autoritetin e inspektoratit të Punës, d.m.th. që pran ministrisë veç egziston inspektorati i punës, atëherë duhet egzistoj edhe Ligji, i cili inspektoriat duhet t'i përmbahet gjatë realizimit të punës së vetë. Gjithashtu është edhe një ligj i cili është shumë i nevojshëm në këtë

kohë dhe në këtë situatë të vështirë të papunësisë së madhe që është Ligji mbi sigurinë dhe shëndetin në punë. Të gjitha këto ligje duhet të aprovohen nga Parlamentti, d.m.th. atje te prioriteti patjetër gjatë këtij viti 2002. Unë e kam edhe një ligj tjetër, është ligji mbi të drejtat dhe autorizimet e Kryqit të Kuq të Kosovës nëpërmjet të cilit Ligj Kryqit të Kuq të Kosovës do t'i shtoheshin fondet dhe ai do të mund të përkujdesej për atë 12% e popullatës e cila egziston në varfëri të skajshme me programe të ndryshme ushqimore dhe sociale. Gjithashtu Qeveria duhet të mendojë edhe për një ligj mbi pagat e punëtorëve dhe orarit të punës së tyre, për shkak se njëri nga deputetët më herët tha se po na krijohen dy shtresa në popullatë, një shtresë shumë e pasur dhe një shtresë shumë e varfër, kurse ky ligj do të pengonte të pasurohen me djersën e punëtorëve të Kosovës, ju falënderit.

Fjala i jepet deputetes Stojanka Petković, le të përgaditet deputeti Driton Lajqi,

Z. STOJANKA PETKOVIĆ,

Gospodine predsedavajući, kolege poslanici. U vezi Programa Vlade Kosova u svoje diskusiji želim da se oskrnem na poglavlje 6, u kojom se daje šema socialne zaštite i na poglavlje 7 koja se odnosi na stvaranje zaposlenosti. Nakon pažljivog isčitavanja ponuđenog teksta u dva naznačena poglavlja to htela bih da verujem da nejasnoće i štuorst is tog proističe iz lošeg tehničkog prevoda ali lično se bojim da se radi o namerno pogrešnom i nezobiljnom pristupu, tretiranju i uvažavanju ovih pitanja i u nedostatku faktičkih činjenica koje prati ovu oblast pitanja života a mislim da su ova i najvažnija pitanja za svo stanovništva koji živi ili potiče sa ovih prostori. Kada se radi o ovim problemima tu politika a naročito ideologija ne mogu mnogo da pomognu. Sama rečenica sa kojom počinje tekst poglavlja VI zvuči nerealno, jer krizni period još uvek nije iza nas. Naime, on je defakto još uvek tu i za nama i sve vreme je prisutan za srpsku nacionalnu zajednicu. Uz sa uvažavanje i napor međunarodne zajednice i svih nas na Kosmetu. Ova pitanja, nažalost i danas opterećuju kosovsku stvarnost. Ovih dana imala sam prilike da posetim mnoga područja na Kosovu i da se lično uverim u strahovitu dramu života nealbanskog a posebno srpskog življa.

U vašem ponudjenom programu, osim deklarativnog naglašavanja da na Kosovu živi 50% stanovništvo u bedi i siromaštvu i da se navode dve kategorije, i to: njih 12% ekstremno siromašnih i obično siromašnih, drugi parametri se ne daju i ne nude. Da bi program Vlade Kosova bio valjan i uspešan, on bi morao pored ostalog da naznači – koliko stanovništvo se nalazi u kategoriji socijalne ugroženosti i potreba za pružanje pomoći i to pre svega mislim na, pod jedan: koliko stanovništvo Kosova u trenutku ispunjava starosnu granicu preko 65 godina radi utvrđivanja sredstava u budžetu u cilju pružanja pomoći u visini od 28 eura mesečno, pod dva: koliko stanovništvo je u statusu hendikepiranosti kojima je pomoć neophodna; tri: koliko se stanovništvo nalazi na evidencijama Zavoda za tržište rada radi zapošljavanja i kakva je njihova starosna, polna, kvalifikaciona, obrazovna, etnička i rezidencijalna struktura. 70% srpske populacije srednjih godina je radno sposobno, ali su ljudi proterani sa svojih radnih mesta, uskraćeno je pravo povratka na svojih radnih mesta, i oni su samimtim socijalni slučajevi, a nemaju pravo da ostvare socialnu pomoć, dakle to su ljudi hraniooci svojih porodica u najboljim godinama i za njih bi trebalo predvideti u budžetu poseban stav koji bi dodiljivao minimalne socijalne pomoći, koja je potrebna za egzistencijalni obstanak, recimo 70 do 80 euro mesečno sve dok ne obezbedi pravo na povratak na svoja radna mesta. 5 koliko porodica i stanovništvo u ovom trenutku živi bez krova nad glavom, odnosno nalaze se u kolektivnom smeštaju ili su beskućnici bez jednog sigurnog oslonca za svoju sigurno egzistenciju i život se nadam liči na dostojanstvo čoveka u današnje civilizovane zajednice. 6 U Programu se nigde ne označavaju izvori sredstava a ova sredstva u svakom slučaju nisu mala, Ne označavaju ni konkretni subjekti koji će biti nosioci programa socijalne zaštite, i preduzetih mera ka ni institucija, počelo od lokalnih uprave na opštinskom nivou do vlade koja nudi ovaj Program. 7 Nema socijalnog programa za reseljenah lica. 8 nije obuhvaćena ni kategorija dece čiji su roditelji stradali u ratu, ili su kidnapovani, ili nestali kao i njihova porodica. Golege poslanici stanovništvo u Kosovu i Metohiji i pre rata a naročito posle rata uvek je bila antipat svih mera standarda i normalnog života, razlozi takvog stanja bili su i ostali zbog jedne naporne Parlamentne stihija koja vladala ove oblasti, kada ovo kažem pre svega mislim na veliki prireštaj koja je enormno povećavao svage

godina broj lica kajima nadležne institucije treden ta pružaju trenda za normalan i dostojanstven život. Veliki broj ljudi koji živi na selu bez osnovne da bi mogli naprediti svoje domaćinstvo, veliki broj i svakim danim sve veći onih lica sa školom i bez škole koji traže zaposlenje, veliki broj lica bez svojih staratelja, i li zbog razvoda brakova, ili zbog smrti rotitelja ili starateljsta, i veliki broj lica bez rešenog stambenog pitanja pre rata i tek sada posle rata i.t.d. i.t.d.koji prate ovu problematiku

Kada je u pitanju nealbansko stanovništvo a posebno u Kosovu stanje je katastrofalno . Više od 65 % ljudi žive bez minimalne naknade sredstava za goli život, 36% ljudi traže prvi put svoje zaposlenje, a mnogi se vode na evidenciji za teržište rada i po 15 godina, preko dve trećine srbskog stanovništva nalazi se u izbeglištvu i to u kolektivnim centrima van Kosova a ostatak živi o porušenim ili oštećenim kućama a Međunarodna zajednica više od milion euro uložila u obnovi izgradni kuća u južnom delu Kosovske Mitrovice, predlažem Skupštini u ime svih građana, da svoj Program još jednom preispita a posebno u oblast socijalne politike i privremenih mera zaštita preispita i..... hvala,

Ftojm deputetin Driton Lajqi a le të përgaditet Agim Krasniqi,

Z. DRITON LAJQI,

E nderuara kryesi, e nderuara Qeveri, të nderuar deputetë. Unë dasha të përsëris ate që tha parafolësi Kuqi, për Qeverinë e njejta por në një formë tjetër vlen edhe për kryetarin dhe kryesin e Kuvendit, mendoj për Rezolutën e aprovuar dje, kërkoj që ajo të mos mbetet në sirtar , mirpo ajo është e kompletuar, e argumentuar me gjendjen faktike nga tereni, tu dërgohet qendrave të vendosjes, ti dërgohet Këshillit të Sigurimit, ti dërgohet Këshillit Evropian. Për shkak se kemi një praktik të hidhur nga e kaluara që dokumentacionet na kan mbetur në sirtarë, ne kemi aprovuar atë rezolutë që të arrihen efektet politike dhe juridike, Ndërsa një prej prioriteteve të mia personalisht dhe mendoj se edhe e shoqërisë kosovare është edhe rinia e Kosovës, siq e dim dikun nën moshën 30 vjeçare janë dikun rreth 50%, do të thotë është një grupmosha jasht zakonisht e rëndësishme, ju e dini që nga e kaluara nuk kemi ndonjë përvojë, rinia më tepër ka

shërbyer si dekorativ apo me ndonjë paragraf atje në fund të Kushtetutës. Në qoftë se kemi një kapacitet, apo një burim aq të rëndësishëm të rinisë së Kosovës, prandaj na duhet një përkujdesje institucionale ndaj saj, Qeveria e Kosovës duhet ta marrë këtë si obligim të vetin për shkak se aty janë mbi 500 mijë njerëz, ajo është energji pozitive, mirëpo në qoftë se nuk do ta kemi në kontroll ata dinë dhe dalin siq thonë jashtë rruge, i shtoj kësaj edhe varfërinë, krizën ekonomike sociale, papunësinë e madhe, shtoj këtu edhe 58 qendra të rinisë në Kosovë mbi 130 organizata joqeveritare, mbi 30 organizata të partive politike, bashkëpunimi ndërkombëtar, gjenerata e kompjuterave ka arritë të depërtoj në Europ dhe në botë. Madje, madje edhe para nesh, shtoj këtu edhe konfliktin e gjeneratave. Ju e dini se nëpër institucionet tona megjithatë sikurse vumë kapak nga sunimi i kaluar, për këtë arsye duhet tu krijojmë hapsirë brezit të ri, ajo është ardhmëria jonë, mos të mbetet vetëm deklarative, prandaj unë kur kam punuar në Departamentin e rinisë e kam pas marrë sinjalin i drejtohem ministrit tash nga Piter Laursen, ky është udhëheqës në Paktin e stabilitetit tryeza e rinisë për aprovimin e planit nacional të rinisë gjithëpërfshirës, edhe programin e ambientit edhe programin e arsimit, edhe programin e shëndetësisë, e dhe programin e kampanjave dhe përfundimisht për ta përfunduar me ligjin e rinisë, Ju falënderit.

Fjalën e ka Agim Krasniqi, kurse le të përgaditet Ivana Markoviq, nga Kryesia është edhe një lutje, që mos të lëshoni sallën, sepse numri i diskutuesëve është zvogluar dukshëm Janë edhe 7-8 edhe ndonjë do të tërhiqet. Besoj dhe shumë shpejt do të kemi pauzën.

Z. AGIIM KRASNIQI,

E nderuara Kryesi e Kuvendit, e nderuara Qeveri, të nderuar kolegë deputetë. Nuk e kam ndërmend të zgjas as 5 minuta, një listë me atë që kam dashtë të them do tia dorëzoj kryesisë së Kuvendit dhe kryetarit të Kuvendit. Por desha vetëm disa fjalë ti them unë kam shfletuar këtë program të Qeverisë dhe vërtet nuk është edhe aq i përkryer, por të jetë i përkryer është e paarrtshme. Këtu ka çështje që do të duhej shtuar duke marrë parasysh edhe debatin e deritashëm, por duhet punuar edhe më tepër me grupe ekspertëshqë. Ky program të jetë komplet, aq sa është e mundur të jetë komplet. Desha të

them që në hyrje këtu pika e parë, konsolidimi i strukturave demokratike të Kosovës, kur zbërthehet në sektore të caktuara, të ndryshme se si do të funksionojnë institucionet demokratike të Kosovës. Këtu ka pak apo nuk ka fare të shkruar rreth disa kryesoreve që në aktualisht nuk e kemi si resor dhe nuk menaxhojmë me to, por megjithatë Qeveria e Kosovës do të duhej të merret me këto çështje, sepse ato çështje për një periudhë të caktuar do të transferohen dhe do të bëhet resore me kompetenca të institucioneve të Kosovës. Vetëm po e citoj faqen 3, ku thuhet se Qeveria e Kosovës përshëndet e OSBE-ë dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtar që punuan në ngritjen e Shërbimit policor të Kosovës dhe konstatimi se Shërbimi policor i Kosovës do të jetë shtyllë e fuqishme e sigurisë së qytetarëve dhe pronës së tyre, kjo nuk do të mjaftonte, këtu më tepër duhet të rregullohet çështja, këtu duhet të bëhen programe operative, mos të them strategjike që do t'i parashohin në faza se kur dhe si do të kalojnë kompetencat nga institucionet kombëtare në ato vendore. Gjithashtu thuhet se Qeveria do të punojë bashkë me UNMIK-un OSBE-në dhe KFOR-in në drejtim të rritjes graduale të kalimit të kompetencave për rendin dhe qetësinë nga policija e UNMIK-ut tek Shërbimi policor i Kosovës, përfshirë parandalimin dhe hetimin kundër krimit. Edhe kjo nuk është aq shumë e zërthyer sa duhet, dhe gjithnji në faqën 3, Qeveria do të mbështes zhvillimin perfeksionimin dhe ngritjen e shkallës së profesionalizimit në TMK-në si organizatë me rëndësi të veçantë për Kosovën, në mbrojtje dhe siguri në raste emergjente, edhe kjo nuk është e mjaftueshme. Besoj se këto tri çështje që i përmenda, Shërbimi Policor i Kosovës, Trupat Mbrojtëse të Kosovës, mënyrat e bashkëpunimit, format e reformimit të punës së deritashme etj. duhet të gjejnë vend të posaçëm në programin e Qeverisë për këtë vit. Po tham për këtë vit, pasi që disa çështje që kanë të bëjnë drejtpërdrejt dhe janë ndërlidh me çështje të gadishmërisë, me çështje të sigurisë dhe emergjencës, ndoshta deri në fund të këtij viti do të bëhet diçkja më tepër se që është bërë deri më tani. Këtë mund ta ilustroj edhe me kreun 5 nenin 5.1 paragrafet a dhe b të Kornizës Kushtetuese për vetëqeverisje e përkohshme në Kosovë, ku thuhet institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes kanë gjithashtu përgjegjësi në fushën e përgaditjes për raste të emergjencës siç janë nën a/ të zhvillojnë dhe zbatojnë një strategji për planifikim në raste emergjente dhe shërbime në nevojën civile dhe nën b/ drejtojnë dhe koordinojnë njësitë e zjarrfikësve dhe shpejtimin në shërbim të ngushtë me institucione përkatëse. E gjithë

kjo duhet të sanksionohet me ligj. Unë jo si kryetar i Komisionit parlamentar për gadishmëri emergjente, por në emër të deputetit kam parapërgadit një propozim për projektligj që do të kalojë përmes kryesisë së Kuvendit, do t'i dorëzohet Qeverisë së Kosovës që të bëjë përgaditjen e një projektligji për gadishmëri dhe çështje emergjente. Është ndoshta absurde, por është e asaj natyre që që sot nuk dim çka është siguria civile, çka është mbrojtja civile, çka është gatishmëria emergjente etj. Dhe krejtësisht në fund në adres të kryetarit të Kuvendit dhe kryesisë së Kuvendit që është përcjell komisioni parlamentar për çështje emergjente ka ardhur edhe një shkresë nga Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arqitekturës që kërkohet po ajo që u kërkua nga disa deputetë më heret, që Kosova duhet ta ketë Stacionin Seizmologjik, kjo nuk do të thotë që duhet a ketë vetëm një por duhet të ketë disa stacione seizmologjike që do të pasoheshin më vonë me krijimin e Institutit seizmologjik të Kosovës, premtojnë se ne kemi kuadro profile përkatëse dhe Instituti mund të bëhet realitet nesër, Ju falënderoj.

Deputetja Ivana Markovi, tërheq diskutimin e saj kështu që në radh është Fadil Kryeziu, kurse le të përgaditet Mahir Jakhillar.

Këta diskutues që paraqiten tash, janë të hequr nga shiriti i kasetës më herët dhe këtu ndërpritet kasetja dhe fillon kështu:

Pra, siç thash më lartë seanca fillon kështu:

Z. NEXHAT DACI,

Më lejoni që të vazhdojmë punimet, para se tua jap fjalën deputetëve të nderuar që janë paraqitur për debat, tju them që OSBE-ja i ka ftuar, gratë unë do të thoja vajzat, deputete në parlament në një drekë, dhe na cakton orën në ora 13,00. Me këtë desha ti njohtoj diskutuesit që të kenë konsiderat ndaj kërkesës për.

Diskutuesi i parë është Sanije Alijaj, nga grupi parlamentar i LDK-së urdhëroni zonja Sanije, Ismajl Kurteshi le të përgaditet pas Sanijes ju lutem.

Z. SANIJE ALIJAJ,

Kryesi e Parlamentit, i nderuari kryeministër dhe ju ministra, deputetë të nderuar. Konsideroj se sot është një ditë shumë e rëndësishme për Kosovën, për shkak se debatohet dhe do të aprovet programi i Qeverisë së Kosovës që besoj se do të pasojnë miratimi i ligjeve që është një kusht për funksionimin e ligjeve të Kosovës në të ardhmen dhe do të fillojë hartimi dhe miratimi i projekteve për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Unë do të ndalem, jam punëtore e arsimit, në disa segmente apo në programin apo në materialin që është hartuar në këtë program. Pajtohem që Qeveria e Kosovës do të angazhohet për një sistem unik të arsimit, dhe do të startoj në vitin e ri mësimor me reformën e arsimit, dhe e kam të njohur dhe të përpunuar edhe Kurikulin për arsim edhe Ligjin për arsim që besoj se në një seancë të ardhshme do të aprovet në këtë Parlament. Por do ti sygjeroja Qeverisë së Kosovës, gjegjësisht Ministrisë së Arsimit, që shumë shpejt të fillojë me hartimin e teksteve shkollore, në harmoni me Kurikulin dhe Ligjin për arsim, sepse për ndryshme reforma apo starti për aplikimin e reformës do të jetë vetëm fjalë e vështirë do të aplikohet në praktikë, vërejtja apo sygjërimi tjetër është se në Programin e Qeverisë, është desht së paku një pasues i veçant ti kushtohet arsimimit të femrës e di që kjo konkretisht është në arsim por së paku këtu do të kishte një vend të

merituar, konsideroj se do të ishte një formulim që edhe mëtej sistemi i arsimit të jetë i menagjuar nga një Qendër, nga Ministria e Arsimit apo konkretisht Qeveria e Kosovës por edhe matutje ai të mbetet sistemi i arsimit i Kosovës. Me një pasus thuhet, në pasusin e pestë të këtij materiali të Programit të Qeverisë, që përgjegjësitë dhe kompetencata e arsimit fillor, parashkollor dhe të mesëm të kalojnë në qeveritë komunale, kjo është e mirë me arsyetimin se do të ndihmojnë nga buxheti vetanak i komunës, rregullimin e infrastrukturës së objekteve shkollore, rritjen e të ardhurave personale të punëtorëve të arsimit, por thash se është e mirë, por kam një dro se ndoshta do të bëhet ndonjë dallim në mes të punëtorëve të arsimit në kuadër të komunave të Kosovës, për shkak se ne shumë mirë e dimë që ka komuna në Kosovë që janë në aspektin ekonomik më të forta, dhe mos po bëhet ndonjë segregacion në mes të kushteve dhe rrethanave në të cilat do të punojnë punëtorët e arsimit. Në këtë drejtim duhet Qeveria të ketë kujdes dhe të ndajë buxhetin për një punë të mirëfillit të arsimit me kohë. Në planin haësinor do ta bëj një kërkesë, që Qeveria e Kosovës të startoj menjëherë në planin haësinor të Kosovës se për ndryshe shumë shpejt deri në vjeshtë do të bashkohet Ferizaji me Prishtinën, prandaj kjo të bëhet urgjentisht, kurse sa i përket fjalës së kryeministrit se Kosova e ka kaluar fazën e emergjencës dhe pothuaj edhe fazën e rindërtimit në Kosovë, unë nuk pajtohem. Derisa RTK-ja përhojë në çdo mbremje emiton një familje që jeton në kushte shumë të rënda nuk do të thojë që në Kosovë ka kaluar faza e emergjencës, gadi aq më pak e kemi rumbullaksuar edhe fazën e rindërtimit. Nuk i kam të dhënat se sa është bërë rindërtimi brenda këtyre tri viteve në Kosovë, Po lidhja demokratike e Kosovës e konsideroj që edhe subjektet tjera në Kosovë i kanë grumbulluar të dhënat për pasojat e luftës në Kosovë. Unë i kam të dhënat për 123 mijë e 300 shtëpi djegura dhe të shkatërruara gjatë luftës në Kosovë, pa i përfshi objektet shoqërore dhe objektet fetare, përmes mjeteve të informimit jemi informuar që edhe shoqatat humanitare kanë ndihmu në rindërtimin e një numri të madh të shtëpive, por e di të dhënë në komunën e Ferizajit janë 1200 shtëpi të djegura, besoni në Ferizaj me ndihmën e shoqatave humanitare janë rindërtu vetëm 250 shtëpi d.m.th. kanë mbetur edhe 1000 të tjera pa ju shtri ndihma nga askush tjetër, prandaj me vlerësimin se kemi kaluar fazën e rindërtimit nuk është në rregull,

Z. Daci, ju lutem për rrespektim të kohës, dhe pasi tia jap fjalën z. Kurteshit, të gjithë deputetët i lus që në rend dite është Programi i Qeverisë dhe të mos humbin as kohën e tyre e as të kolegëve të tyre. Urdhëroni z. Kurteshi dhe le të përgaditet z. Bogoljub Milosheviq.

Z. ISMAJL KURTESHI,

Kryesi e nderuar, z. kryeministër, të nderuar deputetë. Unë do t'i them disa fjalë për bashkëpunimin ndërkombëtar meqë edhe i takjo këtij komisioni, meqë e ardhmja e Kosovës është në integrimin e Kosovës, me vendet me zhvillim të lartë demokratik e ekonomik, mendoj se lidhjet institucionale përmes përfaqësuesve ekonomik e diplomatik me vendet e lartëpërmednura duhet të jen synimi p ermanent i Qeverisë së Kosovës. Duke qen të vetëdijshëm edhe për pengesa të cilat i ka Qeveria. Poashtu konsideroj se Qeveria duhet t'i kushtojë rëndësi të veçantë lidhjeve me emigracionin nga Kosova që është jashtëzakonisht i madh në botën perendimore dhe ndihmën që mund të japë Qeveria sidomos në arsimimin e fëmijëve të emigrantëve tan në botën perendimore. Një çështje tjetër që dua ta them shkurtimisht, është çështja e privatizimit dhe konsideroj që kjo është njëra ndër çështjet më të rëndësishme për qytetarët e Kosovës, prandaj propozoj që Qeveria të bëj ligje të veçanta për privatizimin dhe t'i propozojë Parlamentit që ta thërret një seancë të veçantë për privatizimin, sepse për pronën e Kosovës nuk do të duhej të vendosin grupe të vogla njerëzisht të cilët të emëruar nga përfaqësues të cilët nuk e kanë bazën e popullit, nuk do ta ken edhe të drejtën për menagjimin m e p ronën e Kosovës. Sa i përket çështje së pensionistëve konsideroj se pensioni prej 28 eurove nuk do të jetë zgjidhje për pensionistët, poashtu konsideroj se zgjidhja e çështjes e problemeve të invalidëve të punës dhe invalidëve të luftës janë obligim i Qeverisë dhe për këtë Qeveria duhet të gjejë rrugëdalje për ta zgjedhur, dhe krejt në fund do t'i them dy fjal për çështjen e të drejtave të komuniteteve. Konsideroj se të gjithë qytetarët e Kosovës pa dalim rase, gjinie, feje e përkatësie etnike kanë të drejta por kanë edhe obligime të barabarta të gjith kanë për obligim t'i respektojnë ligjet e Kosovës para të cilëve janë të barabart dhe ata nuk guxojnë as të diskriminohen, as të privilegjojen, sepse cilado çoftë nga këto do ta dëmtojnë Kosovën të ardhmen e saj dhe

qytetarët e saj, dhe në fund e kam një kërkesë për kryetarin e Kuvendit. Ju kisha lutur z. kryetar deputetët të cilët nuk e dinë se si Kosova quhet zyrtarisht tua përkujtoni dhe të mos lejoni që emrin e Kosovës ta bastardhojnë, ju falënderit.

Z. NEXHAT DACI, ju falënderit shumë, z. Bogoljub Milosheviq dhe le të bëhet gati z. Muhamet Kelmendi.

Z. BOGOLJUB MILOŠEVIĆ,

Poštovana Predsedništvo, poštovane kolegince i kolege, poštovanu premijere i ministri, sve vas pozdravljam iz Kosovske Kamenice. Želim da govorim o delu Programa posvećenom pravu manjina, reintegraciju i povratku. Ceo Program ovev Vlade je visoko koncipiran uopšte i malo melagomanski, neka mi bude dozvoljeno da ovaj Program upredim i ovu vladu da uporedim sa organizacijom škole, jer dolazim upravo iz te oblasti, znate ova vlada bi trebalo da bude negde u nivou osnovne škole i da se bavi problemima običnih malih ljudi. Da se bavi problemima ljudi treba da preživi ove vreme tranzicije, međutim ovom programom želi da nam pokaže da je stigla do Universiteta i već hoće evropske integracije, mislim da je malo rano. Svedoci smo da na Kosovu ne poštuju osnovna ljudska prava, radi budućnosti sfih na Kosovu, Vlada treba posebno da se pozabavi implementacijom evropskim konvencijama o ljudskim pravima, Vlada treba preko ministarstva prosvete da uradi program rada sa pripadnicima većinske zajednice u školama, kako bi serazvijalo duh tolerancije i proizlazila neopravdana mržnja prema pripadnicima manjinskih zajednica. Mediji reba da su slobodniji, a umržnje već u duhu mira i toleranciji i zajedničkog suživota, ali integracija pripadnika manjinskih zajednica je neophodna ali ne samo u pogledu ispunjavanja obaveza, već u pogledu ispunjavanja obaveza, već u pogledu živanja prava, Vlada Kosova treba da prevaziđe stalna brojanja i utvrđivanja procenat na svim nivoima, uvek treba dati sposobnim i kreativnim ljudima u svim oblastima. Ali integracija koja ne znači dominaciju većine nad pripadnicima manjinskih zajednica, pogled raselenih lica je neophodan radi izgradnji multietničkog, multi kulturnog i multi konfesionalnog Kosova Da ovo ne bude fraza Vlada Kosova treba da ispoštuje principe povratka i da osigura

određene uslove za povratak Ostali principi povratka su život u izolovanim enklavama pripadnika manjinskih zajednica je neodrživ i treba ga prevazići izgradnjom grupacije naselja, pri izboru naselja ne treba da postoji diskriminatorna ograničenja etničkog karaktera, povratak interno raseljenih treba omogućiti ne već u seoskim, već i u gradskim sredinama širom Kosova kako bi se obezbedili multietnička i multikulturalna budućnost. Vlada Kosova zajedno sa UNMIK-om, KFOR-om i KAPE-som treba da osigura potpuno bezbednost i slobodu kretanja na celom prostoru Kosova. Očuvanje kulturne baštine i utvrđivanju obezbeđivanja vlasništva zemljišta i imovine, pre svakog povratka, pre svake organizacije bilo kakvih povratka, Vlada Kosova treba da garantuje postojanje neophodnih uslova za održiv povratak, a tu spadaju primarne i sekundarne zdravstvene zaštite, predstavljanje prečnosti ustanova osnovnih i srednjih škola, postojanje putne mreže, adekvatno snabdevdanje strujom i vodom, i program zapošljavanja radnih i sposobnih ljudi. Ovo posebno ističem zato što su sva naselja iz koji su serbi proteranih praktično u ruševinama. Vlada Kosova treba zajedno sa UNMIK-om i koordinacionom centrom za Kosovo i Metohiju da uradi definitivno rekonstrukciju 24 grupacije naselja i odredi budžet za rekonstrukciju kuća i drugi neophodnih objekata za održiv povratak. Već ovu stanovništvo Vlada Kosova preko Ministarstvo poloprivrede, šumarstva i seoskog razvoja treba da obnovi poloprivrednu mehanizaciju i stočni fond koji su uništeni kradžama koji su pečeli dolaskom misija traje i dalje. Vlada treba da podrži jedan održiv povratak da bi se raseljena lica vratila i živela punim životom,, vraćenji je treba daveti u mirom zavičaju. Ino, imam konkretan primer u selu Leštar opština Kamenica vratilo se jedan broj ljudi koji stari čekaju tamo da umru. Takav povratak nije potreban, Hvala.

HYDAJET HYSENI,

Fjalën e ka deputeti Muhamet Kelmendi, le të përgaditete Qazim Kabashi.

Z. MUHAMET KELMENDI,

E nderuara kryesi, deputet të dashur dhe e nderuara Qeveri, para se të shprehi mendimin parimor me të cilin unë e mbështes programin e Qeverisë dhe e përshëndes, sepse e shof

si një inisiativë të përshtatshme të mirë në drejtim të ecjes përpara , dhe të pasurimit të këtij programi në të ardhmen, për ndërtimin e shtetit të Kosovës më lejoni të paraqes një kërkesë këtu , para Kryesisë sepse në këtë sallë ne kemi katër parti të vogla politike të cilat nuk i takojnë grupeve parlamentare, ndërsa aspekti juridik dhe kryesia nuk e ka pa të arsyeshme, tju jap dhe tja mundësoj që me katër anëtarë të krijojnë një grup parlamentar, prandaj kanë mbetur si deputet të partive nga vijnë ata deputet të partive politike prandaj çdokund nëpër parlamentet evropiane demokratike dhe plurale, ata deputet që vijnë nga partitë e vogla pas diskutimeve të udhëheqësve të grupeve parlamentare ju jepet fjala dhe bëhet një dallim për deputetët e grupeve politike të cilat janë këtu të përfaqësuara në Kuvend . Kërkoj nga Kryesia që këtë çështje ta shqyrtojë , ose të gjej mundësinë e organizimit të një grupi parlamentar me 4 veta duke u dhan mundësi, ose këtë çështje të cilën e paraqita të jetë një çështje për ta shqyrtuar dhe zgjidhur.

E përshëndes tashti programin e Qeverisë së Kosovës, dhe natyrisht do të votohet për programin e tillë. Se është një e nisme e mirë në drejtim të ecjes përpara , në ndërtim të shtetit juridik të Kosovës, zgjidhjeve të ndara në fushën ekonomike dhe institucionale, të hapjes së dyerve të Kosovës për tu integruar në Unionin Evropian dhe të gjetjes së mundësive të ndryshme për punësimin e njerëzve, e që ne kemi mbi 60-70%. të papunë . Më lejoni që këtu ti them disa çështje të cilat kanë më tepër karakter të përgjithshëm. Në Komizën Kushtetuese në dispozitat themelore flitet që institucionet e Kosovës e kanë për detyrë gjetjen e mekanizmave dhe përgaditjen e terrenit për zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës, duke marrë për bazë vullnetin e popullit të Kosovës. Mendoj se Qeveria është institucioni kryesor, i cili duhet domosdo të ndalet dhe të dikutoj këtë çështje dhe ti shoh afatizimet dhe mjetet dhe metodat se si duhet ecur në drejtim të përgaditjes së terrenit për zgjidhjen dhe hapjen e procedurës për zgjidhjen definitiv statusin e Kosovës. Çështja e dytë që poashtu është e theksuar mjaft qartë dhe prerë në Komizën Kushtetuese është se parashikohet transformimi progresiv i kompetencave, atë që e tha z. kryeministër në Vashington për njërin dhe tjetrën, çështjen dhe kërkesën mjaft e qëlluar që unë e përshëndes që të bëhet kalimi i kompetencave në mënyrë progresive nga organet ndërkombëtare tek vendasit. Edhe njëherë në këtë drejtim Qeveria është ma e thiurrur në përgaditjen e terrenit dhe gjetjen e mjeteve, se si duhet të kalojnë

kompetencat në fusha të ndrrshme të cilat kanë mbetur të rezervuara për përfaqësues të Sekretarit të Përgjithshëm tek organet dhe Qeveria e Kosovës. Së treti është çështja për të cilën ne dje kemi diskutuar, është fjala për Rezolutën të cilën e kemi nxjerrur dhe e cila është shpallur nga kyeadministratori e pavlefshme dhe jovalide. Është fjala për një çështje edhe ne duhet të qëndrojmë edhe më tutje në Rezolutën e tillë, sepse mendoj se është e drejtë kushtetuese dhe e drejtë ligjore e këtij Kuvendi ta aprovojë dhe mbroj atë: Mirëpo edhe një pyetje konkrete i paraqitet faktorit ndërkombëtar nga ky vend dhe mendoj se si duhet të shtrijë Qeveria e Kosovës pushtetin e vetë në tër territorin e vet kur 25% të territorit të Kosovës është jashtë kontrollit, jo vetë të Qeverisë së Kosovës, por edhe të faktorit ndërkombëtar prandaj edhe në këtë an shiquar Qeveria e Kosovës duhet në programin e vet të punës të ndalet, të diskutoj se si duhet ta shtrijë veprimtarinë e vet në këto pjesë të Kosovës, ku aktualisht nuk e ka pushtetin.

Një çështje tjetër që mendoj se është shumë domëthënëse dhe duhet shprehur këtu mendimin, është çështja e punësimit të njerëzve tanë, çështja e zgjidhjes së problemeve sociale, invalidëve të lufës dhe të punës, çështja e familjeve të dëshmorëve dhe familjeve pa prindër. Në çoftë se themi që këto kategori janë shumë të goditura shumë ashpër dhe rënd, dhe të gjitha këto mund të bëhen në çoftë se kemi një zhvillim ekonomik të Kosovës, e për të pasur një zhvillim ekonomik, zonja dhe zotërinj duhet të kemi investime të jashtme, dhe për të pasur investime të jashtme, duhet të kemi një rend stabil, pa krim të organizuar dhe krim tjetër. Edhe një fjali e kam dhe e kreu dhe një status përfundimtar të Kosovës. Nuk mund të gjejë askush investitor të huaj në çoftë se kemi një status i cili fluturon në hapsirën qiellore. Në anën tjetër kemi edhe ata të cilët ende androjnë me andrrat e Millosheviqit për të futur Kosovën në Serbi, dhe në anën tjetër natyrisht se është qytetari i Kosovës, i cili ka luftuar dhe derdhur gjak dhe natyrisht përpiqet sot me mjete politike për të bërë shtetin. Pa shtet të Kosovës mos të llogarit askush që do të kemi ndihma financiare nga bota, Ju falënderit.

Fjalën e ka z. Qazim Kabashi.

QAZIM KABASHI,

Deputeti heq dorë nga diskutimi, atëherë e lusim Naim Malokun kurse le të përgaditet Sabit Rrustemi. Vetëm një sqarim. Meqë u shtrua çështja e kërkesës së deputetëve që përfaqësojn jo grup parlamentar, por një parti, ne kemi shqyrtuar çështjen e tyre kemi shqyrtuar mundësin që t'u dalim në ndihmë kërkesave të tyre. Deri më tani nuk kemi arritur të gjejmë një qëndrim, do të përpiqemi që ti kemi ky trend ku një bartës ose një udhëheqës i një kompanie publike, të ardhura personale ka mbi 4 mijë marka gjermane dhe një pensioner i Kosovës 28 euro atëherë si mund të flasim për një shoqëri demokratike, si mund tu ofrojmë ose të kërkojmë nga qytetarët e Kosovës për të respektuar institucionet e saj dhe si mund të themi se institucionet e Kosovës kujdesen për të gjithë qytetarët e Kosovës barabart, po flas për institucione publike e jo për ato private. Zonja dhe zotrinjë ky është një dallim i jashtëzakonshëm dhe nuk mendoj që mund të jetë në vende tjera, prandaj Qeveria definitivisht duhet ...

Këtu përfundon inçizimi i kësaj kasete dhe fillon në kaset të re, dhe fillon kështu.

Në foltore paraqitet Kryeministri Bajram Rexhepi.

Z.NEXHAT DACI, i shprehi mirëseardhje kryeministrit të Kosovës, ta pakëzoj

Z. BAJRAM REXHEPI

E nderuara Kryesi e Kuvendit, i nderuar kryetar, të nderuar deputetë. Menjëherë nga dita e konstituimit të institucioneve, hapin e parë që e ka ndërmarrë Qeverija e Kosovës ishte fillimi i hartimit të Programit të punës së saj. Meqenëse Qeveria e ka një bazë të gjërë të spektrit politik dhe u formua mbi bazën e marrëveshjes, jemi përpjekur që Programin ta hartojmë duke i pasur parasysh 8 pikat që e obligojnë Qeverinë nga marrëveshja e 28 shkurtit 2002, duke i konsultuar programet zgjedhore të tri partive politike që e përbëjnë Qeverinë, por njëkohësisht edhe ministrat. Natyrisht që Programi nuk i tejkalon kufizimet që i bëjnë Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit dhe Korniza Kushtetuese. Funkcionimi i Institucioneve të Kosovës, në këtë rast i Qeverisë do të mbështetet në dokumentet bazë, Rezolutën 1244 qershor 1999, Kornizën Kushtetuese të Kosovës maj 2001, rekomandimet e propozuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm z. Shtajner, dhe të aprovuara nga Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, prill 2002, si me ligjet dhe direktivat që i aprovon Parlamenti i Kosovës. Përmbushja e parametrave të dokumenteve të theksuara më lartë janë kushte paraprake për realizimin e aspiratave të popullit të Kosovës, dhe zgjedhjen përfundimtarë të stautit të saj. Arsyeja e vonësës së deritashme për shqyrtimin e Programit, konsiston pikërisht në faktin se të gjitha këto dokumente janë konsultuar dhe analizuar hollësisht dhe se nuk kemi dashur ta dërgojmë në Parlament për shqyrtim pa e harmonizuar me këto dokumente, dhe pa e pasur koncenzusin e të gjitha ministrive. Duke i pasur parasysh të gjitha problemet që ballafaqohet shoqëria jonë, jemi përpjekur që t'i kategorizojmë ato dhe ti fokusojmë prioritetet themelore të cilat duhet të orientohet për ti zgjedhur menjëherë. Ne nuk duam të jemi nihilist dhe t'i mohojmë të arriturat e shumta që janë bërë në Kosovë gjatë periudhës së pasluftës, Tani kemi premisa të mira për ti thelluar proceset pozitive politike dhe zhvillimore në Kosovë.

Në Programin e Qeverisë i kemi fokusuar objektivat tona drejt konsolidimit të institucioneve demokratike, krijimit të administratës efikase dhe transparente, krijimit të kornizës ligjore për të gjithë sektorët, krijimit të një klime stabile dhe të sigurtë për të gjithë qytetarët e Kosovës, zgjerimit të politikës fiskale duke i rritur burimet e të hyrave në buxhetin e konsoliduar të Kosovës, zhvillimin ekonomik, bashkëpunimin me faktorin ndërkombëtar, bashkëpunimit në regjion, thellimin e reformave në arsim e shëndetësi përkujdesjen sociale ndaj kategorive të rrezikuara të shoqërisë sonë, zbutjen e papunësisë, integrimin e pakicave, rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e menaxhimit me ndërmarrjet publike, transformimin e pronës, krijimin e premisave të dobishme për fillimin e procesit të privatizimit, pa kujdesjen për ruajtjen e ambientit, pengimin e dukurive negative, si korrupsioni, krimi, kontrabandës, trafikëve të paligjshme dhe dukurive të tjera devijante në shoqëri, me një fjalë objektivi e jonë është krijimi i një shteti ligjor të bazuar në normat e demokracisë perendimore dhe të ligjeve të ekonomisë së tregut të lirë.

Duke e ditur se çelësi i zgjidhjes së të gjitha problemeve në Kosovë, është zhvillimi ekonomik, përpjekjet tona më të mëdha do të shkojnë në këtë drejtim, Kosova e kaluar fazën e emergjencës, edhe thuhet jemi në përmbyllje të fazës së rindërtimit të pjesëve të shkatërruara nga lufta. Tani duhet të hyjmë në fazën e zhvillimit. Kusht primar për të pasur sukses në këtë fazë është krijimi i kornizës së nevojshme ligjore për investime zhvillimore në Kosovë. Ne jemi të orientuar që investime të kërkojmë nga jashtë, nga bashkëatdhetarët tanë në Kosovë, por edhe nga qytetarët vendas. Aktualisht në Kosovë kemi vakum ligjor, sepse në shumë fusha veprohet në bazë të rregulloreve të UNMIK-ut dhe të të ashtuquajturave ligje të aplikueshme.

Me qëllim të krijimit të kornizës së mirëfilltë ligjore, duke u bazuar në prioritetet e Qeverisë, ne kemi paraqitur ligjet themelore që kemi konsideruar se është e domdoshme të aprovohen nga Parlamenti gjatë këtij mandati, por kjo nuk do të thotë se duhet të përqëndrohemi ekskluzivisht vetëm në këto ligje të propozuara, se vërsisht nga rrethanat, ministrat dhe komisionet parlamentare do të kenë mundësi të propozojnë edhe ligje të tjera shtesë për aprovim.

Duke theksuar se në matriksën e ligjeve të propozuara, ka një lëshim teknik, sepse parashihet edhe aprovimi i ligjit për arsimin e lartë, dhe të ligjit për pensionistët, Qeveria kërkon mbështetjen e Parlamentit dhe të qytetarëve të Kosovës në drejtim të realizimit të objektivave qeveritare. Programi Qeveritar do të mund të realizohet nëse do të kemi bashkëpunim të ngushtë institucional dhe secili të jetë në nivel të përmbushjeve të obligimeve dhe përgjegjësisive tona institucionale.

Dhe në fund do të doja të theksoj, se gjatë qëndrimit tonë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në biseda me Bankën Botërore, dhe me fondin monetar ndërkombëtar, rreth programit të cilin ata e kishin studijuar, programi ynë është vlerësuar lartë nga këto institucione të rëndësishme ndërkombëtare. Ju falënderit, presim vërejtjet dhe komentet e juaja, pastaj do të jemi në dispozicionin tuaj për ndonjë sygjërim eventuale, vërejtje, Ju falënderit.

Z. NEXHAT DACI, zotëri kryeministër, ju falënderit, urdhëro z. ministër

Z. BEHXHET BRAJSHORI,

E nderuara Kryesi, të nderuar deputetë, desha që t'ju bëj me dije se ju keni marrë një amendament shtesë të Ministrisë sonë, në kuadr të ndryshimit të asaj pjese që ka të bëjë me sportin dhe dëshiroj tju njohtoj se është lëshim teknik dhe ju e keni para vetes. Pra, sipas rregullës 25 neni 4 i rregullave të përkohshme të procedurës së Asamblesë së Kosovës, dëshiroj të bëj në korigjim të Programit qeveritar në seksionin 10, lidhur me Ministrinë e Kulturës, Sportit dhe Rinisë dhe çështjeve rrezidente, pasi që dokumentet që prezentohen në Asamble e lënë anash një iniciativë të rëndësishme të Departamentit, përkatësisht Ministrisë së Sportit, Rinisë, Kulturës dhe çështjeve jorezidente, për t'i mbështetur sportistët kosovarë për pjesëmarrje në gara ndërkombëtare, dhe ndryshimi është, paragrafi që ka të bëjë me sportin, i cili përfundon në faqen 31 versioni shqip, të dokumentin mbi Programin e Qeverisë duhet përfshirë fjalinë vijuese në fund të paragrafit, pra fjalia është: Qeveria do të përkrah federatat e sportit, duke Ju mundësuar sportistëve kosovarë që të marrin pjesë në arenën ndërkombëtare.

Kjo poashtu edhe te matriksa ku e keni një lëshim teknik, që ka të bëjë me ligjin mbi trashëgimin e kulturore, do ta gjeni atje në radhitje , afati i nxjerrjes është 31 mars 2003 e jo si qëndron 2002, do të thotë është një lëshim teknik, Ju falënderit.

Z. NEXHAT DACI, ju falënderit z. ministër urdhëroni prapë ministrat, ministri për Arsim Shkencë dhe Teknologji.

Z. REXHEP OSMANI,

Në materialin që e keni marrë, ku është paraparë dinamika e ligjeve , ku është në faqen ku flitet për ligjin për shkollimin fillor dhe të mesëm, që është paraparë të miratohet para 30 qershorit 2002, duhet të shtohet edhe ligji mbi arsimin e lartë, d.m.th. këto dy ligje duhet të shkojnë, ligji mbi arsimin fillor dhe të mesëm, dhe ligji mbi arsimin e lartë. Dhe në faqën e njejtë ku flitet për arsimin , duhet të shtohet atje se ligji për arsimin fillor dhe të mesëm dhe ligji mbi arsimin e lartë janë dy ligje të parar që Qeveria ka menduar ti bartë para Parlamentit për miratim. Ju falënderit.

Z. NEXHAT DACI, falënderit z. Ministër.

Besoj që mund të fillojmë. Është paraparë që udhëheqësit e grupeve parlamentare të kenë në disponim nga 15 minuta për të shprehur mendimet e grupeve parlamentare. Shpresojmë se nuk do ta shfrytëzojnë racionalisht këtë kohë, pastaj do të këtë paraqitje të tyre deputetët që janë paraqitur e që janë paraqitur 32 deputetë është paraparë që ata të kenë në dispozicion 3 deri në 4 minuta maksimumi do të jetë 5 minuta. Prandaj, për të mos humbur kohë ftoj udhëheqësin e grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës , të jap mendimin e tij. Urdhëroni z. Hamiti.

Z. SABRI HAMITI,

Kryesi e çmuar, z. kryeministër, deputetë të nderuar. Është një ngjarje sot që po nisim të bisedojmë për Programin e Qeverisë sonë. Ne siç e dini kemi një Qeveri të koalicionit

dhe që në fjalën e vet kryeministri tha që edhe në hartimin e këtij programi të Qeverisë, natyrisht që janë marrë parasysh pos pikave të marrëveshjes për formimin e saj edhe programet e partive më të mëdha që edhe e kanë krijuar këtë Qeveri. Unë jam përpjekur ta studijoj këtë propozimprogram, me fuqitë e mija natyrisht në pjesët ku e njof më mirë veprimtarinë tjerat pjesë më pak. Sido që të jetë ne e marrim me seriozitetin më të madh punën e diskutimit të programit të Qeverisë, problemin e aprovimit të saj. Ajo që bie në sy në këtë tekst, ashtu se ndoshta rrethanat e politikës së jashtme dhe të brendshme të Kosovës dhe mënyrës së qeverisje dyshe përmes një bashkëpunimi në mes të organeve të vendit dhe atyre që vijnë nga gjashtë, ka bërë që teksti i programit të duket më shumë si një kontratë politike se sa si një program që i ka vlerat e operacionalizimeve ose të punëve, problemet që janë substanciale, mënyrat e zgjidhjes së tyre, metodat dhe mjetet, Prandaj mendoj që në diskutimet që do të ndodhin këtu e edhe në ndonjë bashkëdiskutim ose dialog me ministrat e resoreve të ndryshme do të precizohen shumë probleme, do të bëhen më të qarta, edhe eventualisht do të propozohet ndonjë kalendar i veprimeve konkrete, në gjithë programin nuk ka ndonjë adresim në kohë, përpos që ne mund të supozojmë që programi parasheh kohën prej mandatit që ka Qeveria.

Po them në përgjithësi është një hartim i cili do të mund të ishte më substancial si tekst shumë më i shkurtër, dhe më pikant në evidentimin e çështjeve me të cilat do të punohet dhe metodat që do të punohet. Unë do të përmendi disa pika themelore që bien në sy e që duan ndoshta një diskutim të natyrës më të veçantë. Kryeministri thotë që programi është mbështetur në marrëveshje në programet e kualicionit, në Rezolutën 1244, Kornizën kushtetuese, në rekomandimet e Shtajnerit që janë mirëpritur ose janë përkahur nga Këshilli i Sigurimit dhe në fund ligjet e Parlamentit nuk e di pse ky rend. Unë megjithatë kisha ndryshuar rendin dhe se kisha lënë ligjet e Parlamentit në fund hiç, por në fillim, nëse Qeveria është e Kosovës dhe del nga Parlamenti i Kosovës dhe kjo Qeveri ka mandatin e Parlamentit të Kosovës, pse po them kështu, po them kështu për të hyrë në esencën me të cilën do të ballafaqohemi dhe jemi ballafaquar këto ditë dhe tutje, e që në këto krijuar institucionet dhe heqëse të Kosovës me votën e lirë dhe në kërkojmë që këto institucione të marrin përgjegjësinë e vërtet të veprimit politik në Kosovë pa marrë parasysh që kjo punë e tyre do të jetë gjithësesi e lidhur në

bashkëpunim me ato organizata ndërkombëtare që kanë funksione udhëheqëse, politike dhe ushtarake në Kosovë.

Këtu menjëherë dalim te problemi i këtyre raporteve i cili nuk është ndërtuar ende në nivel funksional, ende është më shumë në nivelin deklarativ, kjo shihet edhe në një ritëm tepër të ngadaltë të ndërtimit funksional të institucioneve të Kosovës dhe unë menjëherë këtu po them t'i iket emrit të përgjithshëm se emri i përgjithshëm nuk thotë asgjë, siç nuk thonë institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës IPQV. Emrat e përgjithshëm janë shumë të këqinj edhe në jetën e përditshme edhe në jetën politike, sepse emri i përgjithshëm humb karakteristikën dhe obligimet. Prandaj, unë them në qoftë se edhe në këtë dokument të thuhet programi i Qeverisë dhe ta ketë një shenjë të Qeverisë së Kosovës, sepse nën nuk kemi institucione por në kemi Qeveritë të Kosovës, kemi Parlament të Kosovës, kemi kryetar të Kosovës, ky emër i përgjithshëm ngatërron punë shumë dhe unë mendoj se duhet të hiqet edhe në komunikimin tonë politik, por edhe në jetën e përditshme, siç nuk duket i mirë përkufizimi i përgjithshëm qoftë edhe në këtë tekst të programit të Qeverisë, por edhe në diskutimet rreth këtyre programeve kur te termi „ndërkombëtarët,“ kjo nuk thotë shumë sepse prapë pas këtij emri të përgjithshëm mund të mbështillen edhe të ngatërrohen nivele, ngatërrohen pikëpamje, interesa që ta dini se nuk janë njësoj hiq. Ndërkombëtar emër i përgjithshëm nuk thotë shumë. Kur jemi këtu unë po them menjëherë që edhe praktika jonë që na ka sjell deri këtu, por edhe kjo që do të shkojë tutje ne na ka mësuar që ekzistojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës pa të cilat ne nuk do të shpëtonim nga gjenocidi serb dhe nuk do të kishte mbrojtje të shqiptarëve në Kosovë, edhe tutje po shtoj se mendoj as zhvillimet demokratike në Kosovë nuk do të ecin me ritimin e kërkuar pa ndihmën e Shteteve të Bashkuara, pas tyre vijnë edhe të tjerët natyrisht, po ka diferencime edhe në interes, ka diferencime edhe në përkushtime, dhe këto janë shumë të qarta dhe shumë të dukshme këtu po hyj në raportet ndërkombëtare t'i quaj ashtu që dalin si pika e fillimit të programit dhe unë kujtoj që në këtë pjesë është mirë që të dalë një formulim në pjesën hyrëse të programit që Qeveria e Kosovës me të gjithë resorët e vet do të punojë me gjithë kapacitetin e vet për ndërtimin e demokracisë në Kosovë dhe për krijimin e kushteve të zgjidhjes së statusit politik të Kosovës. Unë mendoj që një formulim si ky ose i ngjashëm duhet të rrijë në ballë të programit ose aty kah fillimet e tij. E dyta,

raportet që i mora pak nëpër gojë tash me ndërkombëtarët duhet të ndërtohen substancialisht, jo vetëm si deklarim se ju e dini apo pse të mos themi ne i kemi nja 3 – 4 u dhëheqësia ndërkombëtarë që ka qenë këtu përfaqësues special që po i thoni të sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, të cilët nganjëherë japin deklarata pak si të quditshme, ne kemi pasur njerin që ka thënë unë jam mbret, e në Kosovë mbretni nuk ka pasur kurrë, një tjetër që thotë unë jam yll e Kosova nuk është në hava, por është në tokë, bile është tokë herë e butë e her e sertë dua të them të kalojmë nga nivelet e figurave personalizuese në nivelet e veprimeve konkrete politike dhe shoqërore në Kosovë dhe këto raporte të ndërtohen në punë dhe jo në deklarime. Pra edhe ky raport me organizma që janë këtu si bashkëpunues do t'i quaja unë edhe raportet me shtetet në rajon, unë kujtoj që duhet të ndërtohen në nivelin e bashkëpunimit dhe të interesave, sepse të gjitha raportet tjera dalin të rrejshme dhe jofunksionale. Në anën tjetër kujtoj që Qeveria si një prej organeve më të larta më funksionale të Kosovës e dalë nga vota e lirë për Parlamentin, poashtu edhe për presidentin e Kosovës të krijojnë raporte me politika që quhet politika e jashtme me shtetet veç e veç dhe me organizmat ndërkombëtarë dhe të mos u zihet fryma siç ka ndodhur disa muaj të fundit në raportet me jashtë, të mos mbetemi njëfarë getoje e brendshme e Kosovës e cila përpiket që të funksionojë këtu, ndërsa raportet me jashtë i mbajnë përfaqësuesit që edhe ashtu janë përfaqësues të jashtëm, kjo hetohet shumë dhe unë pres që kjo do të thyhet, dhe pres që vizita e z. kryeministër në Amerik ishte një hap i thyerjes së kësaj, unë pres që të shkohet në këtë vij që informacionet direkte të shkojnë përmes përfaqësuesve direkt të shqiptarëve e jo përmes ndërmjetësuesve, sepse ndërmjetësuesit edhe ashtu edhe i kemi të dërguar na këtu. Sa i përket Programit konkret unë kisha shumë çka të them sepse e kam lecur kujdesshëm në pika të ndryshme, do të ndalaesha në dy tri pika, te Arsismie.sh ministri i arsimit tha dhe e plotëslj dhe mirë bani që tha se do të nxiret ligji jo vetëm për shkollimin fillor, të mesëm por edhe për Universitar, dhe unë konsideroj se ajo është e domosdoshme dhe është njëri nga ligjet themelore pa të cilin nuk ban sepse hym në vjesht në vitin e ri shkollor.

Në këtë Program që është dhanë për arsimin, ne kemi dy paragraf në fillim, ku thuhet se Qeveria e Kosovës do të ndërtojë një sistem unik të arsimit në Kosovë. Reforma e sistemit arsimor, shkollimit fillor dhe të mesëm është prioritet i qartë i Qeverisë,

pastaj thuhet gjithashtu do të vazhdojmë të inkurajojmë dhe mbështesin reformat e vazhdueshme në Universitetin e Prishtinës etj. Unë mendoj se në program është dashur të jetë shumë më i qartë formulimi i asaj që duhet të bëhet në arsimin. Këto nuk mjaftojnë, këto nuk obligojnë, këto nuk janë substanciale. Unë e njof mirë punën në Universitet, ka këtu që e njofin shumë mirë, unë po iu them që jo vetëm në shkollat fillore dhe të mesme, por as në Universitet nuk do të ketë kurfarë reforme pa para, pa financa. Ju e dini që Universiteti është institucioni më i lartë i arsimit dhe i dijes në Kosovë, ju e dini që është institucion që prodhon dije dhe bart dije te tjerët, instrument i mendjes, por në gjendjen materiale që është Universiteti i Kosovës të gjitha ato reforma të deklaruar do të mbeten në letër. Duhet të, planifikohet, të krijohet ligji, atëherë të parashihet saktë financimi i Universitetit të Prishtinës, sepse nëse është Universitet shtetëror ne marrim përgjegjësi direkt këtu për funksionimin e tij. Nuk mundet të reformohet të bëjë kualitet kërkimor dhe arsimor Universiteti i Prishtinës duke qenë i paguar profesori i cili e ka titullin më të lartë me çmime që janë qesharake karshi të marrurave tjera që ndodhin në Kosovë, të mos flasim edhe për nivele edhe më të ulta. Kjo nën një, nën dy konsideroj që atje ku flitet për pensionistët nuk ka ende zgjidhje. Një 28 euro që është njëfarë i çuditshëm që e ka nxjerrë çdo njeri mbi 60 vjet, i merrë ato janë një sistem që unë kujtoj nuk mund të funksionon, nuk është i plotë dhe duhet të gjinden zgjidhje të shpejta për këte. Në të tretën pikë që duhet të tërheq vëmendjen tuaj është pjesa e kulturës. Unë konsideroj që teksti ku flitet për kulturën është problem, kur politika krijon formulime për kulturën gjithnjë kanë qenë gjëra që bëjnë formulime të pakëndëshme edhe këtu ka formulime të këtilla, që nga fjalia e parë. Unë kisha thanë që ky program i Qeverisë, sa i përket kulturës të hiqet nga pretendimet e formulimeve ideore që të thuhet ideologjike, lë të propozojë konkretisht çka Qeveria jep për institucionet nacionale të kulturës, çka jep për vlerat nacionale, çka jep për botimet nacionale, të cilat në çdo shoqëri të organizueme financohen dhe ndihmohen nga shteti, sepse janë vlera nacionale dhe nuk ju shtrohen ligjeve të ashpra të tregut të cilat ju e dini se prodhojnë jokulturë, subkulturë. Nëse bisedojmë në nivelin institucional për kulturë, Qeveria jonë, organet tona qeveritare duhet saktësisht të tregojnë çka financojnë dhe çka është interes i kulturës nacionale.

Z. NEXHAT DACI, ju falënderit z. Hamiti edhe për korrektësinë e respektimit të kohës, fjalën e ka udhëheqësi i grupit parlamentar të PDK-së z. Limaj, urdhëroni,

Z. FATMIR LIMAJ,

